Tregu i sigurimeve vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.43% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 6.56%⁶. Këto të dhëna reflektojnë gjithashtu mungesën e marrjes së masave konkrete për zhvillimin e tregjeve të Jetës duke bërë që kjo klasë sigurimesh të mbetet mbrapa në raport me sigurimet në përgjithësi. Në mendimin tonë, duhet që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të ndërmarr nisma konkrete për të propozuar sigurimin e jetës si një sigurim të detyrueshëm nga të gjithë individët pasi në këtë mënyrë, nuk do të rritet vetëm cilësia e jetës të çdo qytetari por edhe tregu i sigurimeve do të zhvillohet në mënyrë të shpejtë e të sigurtë. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë

37.79% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.21% të totalit të tregut⁷.

Nga ana tjetër, sektori i dytë i tregjeve financiare, tregu i letrave me vlerë i jep mundësinë individëve të bëjnë më shumë me kursimet, idetë dhe talentet e tyre, krahasuar me çdo treg tjetër⁸. I quajtur ndryshe tregu i investimeve, ai shërben si një mënyrë mjaft efikase nëpërmjet të cilës individët, firmat apo qeveritë mund të rrisin të ardhurat e tyre. Këtë gjë ata e bëjnë duke shitur dhe blerë letra me vlerë në tregun e kapitaleve. Në fillim të analizës sime mbi zhvillimet e këtij tregu është e nevojshme të ndalemi në përkufizimin e dy koncepteve të rëndësishme financiare që lidhen pikërisht me këtë treg: *letra me vlerë*, të quajtura ndryshe, mbi bazën e legjislacionit të ri në këtë fushë, *tituj* dhe *treg i letrave me vlerë*.

Përkufizimi i këtyre termave është i nevojshëm jo vetëm për të kuptuar qartë këtë studim por mbi të gjitha për të kontribuar sado pak në pasurimin e doktrinës shqiptare në fushën e tregjeve financiare, e cila fatkeqësisht është ende shumë e vakët.

Sipas legjislacionit shqiptar, në termin "*tituj*" përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që më poshtë do të quhet Autoriteti⁹. Ndërkohë që doktrina përpiket të jap një dimension më të gjerë të letrave me vlerë, duke bërë të mundur që ky përkufizim të jetë i aplikueshëm pothuajse në të gjitha vendet e botës. Në fakt është e kuptueshme që përkufizimi i titujve të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme të botës, për aq sa neve dimë që ekzistojnë dallime të rëndësishme ndërmjet sektorëve financiarë, por pavarësisht kësaj, ai ka elementë të përbashkët,

⁷ Po aty.

⁸ Bajpai G.N., (2003) *Significance of Securities Market in the Growth of an Economy: An Indian Context*. Artikull I publikuar në: http://www.sebi.gov.in/cms/sebi_data/attachdocs/1288676814777.pdf

⁹ Neni 3 I ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt".

⁵ Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2020

www.amf.gov.al

6 Po aty.

të cilat qëndrojnë në thelb të vetë ekzistencës së tij. Sipas doktrinës ndërkombëtare, në kuptimin e letrave me vlerë hyjnë të gjitha ato forma të pronësisë që mund të tregëtohen lirisht në tregjet e kapitalit¹⁰. Letrat me vlerë janë çertifikata investimi të cilat përfaqësojnë kapitalin (pronësinë në një korporatë të caktuar) ose borxhin (kredi dhënien për një emetues të caktuar¹¹r).

Titujt ose letrat me vlerë tregëtohen në tregun e letrave me vlerë. Përkufizimi ligjor i *tregut të letrave me vlerë* është dhënë për herë të parë nga ligji nr. 8080 datë 01.03.1996 "Për letrat me vlerë". Sipas nenit 2 të këtij ligji:

"Tregu i letrave me vlerë", nënkupton një bursë kapitali apo të letrave me vlerë apo ndonjë treg tjetër, një sistem apo vend tregtimi, me anë të të cilit:

(a) ofertat për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlerë kryhen dhe pranohen rregullisht;

(b) ofertat apo kërkesat kryhen rregullisht, kur janë oferta apo kërkesa të paracaktuara, apo janë të pritshme, që rezultojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në bërjen apo pranimin e ofertave për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlerë; ose

(c) jepet informacion rregullisht lidhur me çmimet dhe shpërblimet që persona ose grupe të veçanta propozojnë, apo presin, të shesin, të blejnë apo të këmbajnë letrat me vlerë.

Në kushtet e pandemisë, vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2020, u dominua në masën 65.73% nga transaksione në instrumente

afatshkurtër (bono thesari) dhe 34.27% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione)¹². Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 88.45% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari¹³. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.58% të të gjitha transaksioneve në këtë treg¹⁴.

Sektori i tretë i rregulluar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare është tregu i pensioneve private suplementare. Sistemi i pensioneve në Shqipëri përbëhet nga skema publike pay as you go (kolona e I-rë) e administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si dhe skema vullnetare private (kolona e III-të) e administruar nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit¹⁵. Skema publike "Pay as you go" mbështetet në modelin Bismarck-ian, ku kontributet dhe përfitimet përcaktohen në raport me pagën, si dhe në parimin e solidaritetit të brezave. Ndërkohë skema vullnetare private është subjekt i AMF-së dhe pjesë e rëndësishme e tregjeve financiare jobankare.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2020, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare për këtë periudhë tregon një total asetesh neto prej 3,238.68 milionë lekë dhe me një rritje prej 334.61 milionë lekë (11.52%) krahasuar me fundin e vitit 2019¹⁶. Ajo që vlen të përmendet në këtë pjesë është se ky sektor i tregjeve financiare jobankare është i vetmi sektor që gjatë pandemisë pati një zhvillim të qëndrueshëm, madje edhe në nivel rritës.

3. Problemet e shkaktuara nga kriza financiare e pandemisë

Ndër problemet kryesore që ka shkaktuar kriza e pandemisë është mungesa e likujditetit dhe kërcënimi i qëndrueshmërisë së tregjeve financiare. Për të vlerësuar sesa i aftë është një

¹⁰ Choi S.J. and Pritchard A.C., *Securities Regulations: The Essentials*. Wolters Kluwer Law & Business. Aspen Publishers 2008, f. 53-82; Amadeo K., *Securities*, Artikull I botuar në portalin ekonomik US Economy. <http://useconomy.about.com/od/glossary/g/securities.htm> ; Susan Sushu Yin, *A Global Regulatory Framework for Transnational Securities Markets*, A thesis submitted for the degree of Doctor of Philosophy in the University of London (Queen Mary College) 2013. f. 41

¹¹ Gitman L.J. and McDaniel C., *The Future of Business: The Essentials*. Published by South-Western, a part of Cengage Learning, 2009. f. 440

¹² Raporti Statistikor Janar – Shtator 2020, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Zaho L., *Tregjet dhe institucionet financiare*. Tirane 2009.

¹⁶ Raporti Statistikor Janar – Shtator 2020, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

sistem për të përballuar rreziqet e mundshme që mund t'i shkaktohen tregjeve financiare duke i destabilizuar ato, gjithmonë vështrimi duhet të jetë nga e ardhmja. Në këtë analizë duhet vlerësuar realisht se si ka ndikuar pandemia e koronavirusit mbi ekonominë dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Pandemia e Covid - 19 ka ndikuar drejtëpërdrejtë në sjelljen e çdo individi duke shkaktuar ndryshim në sjelljen e jetës së tyre të përditshme, ndikuar kjo edhe nga masat shtërnguese të qeverisë, e cila për të shmangur përhapjen e gjerë të saj në periudha të caktuara ka ndërmarrë edhe masa shtrënguese të rëndësishme. Këto masa kanë ndikuar padiskutim edhe në aktivitetet ekonomike të çdo individi, ndikimi mbi të cilin edhe pse do të jetë i përkohshëm, përsëri do të jetë i ndjeshëm. Si rezultat i këtyre masave, sektori bankar, ai i sigurimeve, si dhe fondi i investimeve kanë pësuar një rënie mjaft të madhe duke cënuar realisht edhe qëndrueshmërinë e tyre. Më konkretisht, ndërmarrjet private dhe publike (me përjashtim ndoshta të atyre që ofrojnë shërbime jetike bazë), në varësi të aftësisë së tyre për t'u përshtatur qoftë edhe pjesërisht, mund të pësojnë dëmtim të zinxhirit të marrëdhënieve tregtare dhe do të ndjejnë mesatarisht një rënie të theksuar të shitjeve të mallrave e të shërbimeve¹⁷. Kjo do të sjellë rënie të të ardhurave dhe vështirësi për të përballuar detyrimet financiare të veprimtarisë që lidhen me shpenzimet fikse dhe ato variabël¹⁸.

Këto vështirësi do të reflektohen padiskutim edhe në sektorin e punësimit. Kjo pasi ndërmarrjet, në pamundësi për të përballuar shpenzimet e tyre, do të jenë të detyruara të shkurtojnë vendet e punës. Humbja e punës për një individ, do të thotë ulje e të ardhurave. Dhe në një efekt zinxhir, do të thotë rënie e ekonomisë në tërësi, kjo pasi individët do të limitohen në shpenzimet e tyre, madje, në qoftë se shkojmë akoma më tej me këtë logjikë, kjo mund të ndikojë edhe në sektorin bankar. Kjo pasi, shumë individë mund të kenë vështirësi në shlyerjen e kredive të marra në institucionet financiare, duke sjellë rënie të cilësisë së kredisë në këto institucione dhe ndikim negativ në rezultatin financiar.

Nga sa më sipër, është e nevojshme, madje edhe emergjente që operatori publik, nëpërmjet

institucioneve financiare të ndërmarr një sër hapash të rëndësishëm për reformimin edhe një herë të të gjithë sektorit financiar. Në këtë fazë është e rëndësishme që të gjithë operatorët që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun financiar të kenë funksionale plane të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave.

Në linjë me rekomandimet e autoriteteve rregullatore europiane, AMF ka udhëzuar shoqëritë e sigurimit që të vlerësojnë efektet e pandemisë për konsumatorët, të qartësojnë kushtet e kontratave duke specifikuar rastet e mbulimit ose jo për produktet që lidhen me pandemitë, si dhe të përditësojnë faqet e tyre zyrtare me seksione të dedikuara lidhur me ndikimin e COVID-19¹⁹.

4. Konkluzione

Situata botërore e pandemisë ka kërcënuar drejtëpërdrejtë tregjet financiare duke rrezikuar madje jo vetëm periudhën aktuale të ekonomisë së vendit tonë por edhe të ardhmen e saj pasi ecuria e këtyre rreziqeve është ende e paqartë. Për këtë arsye është e nevojshme që të harmonizohen veprimet e operatorit publik, autoriteteve rregullatore dhe subjekteve të tregjeve financiare, në mënyrë që kjo krizë të kapërcehet pa pasoja të rënda për këto tregje.

Ndër sfidat më të rëndësishme të autoriteteve rregullatore krahas qëndrueshmërisë së tregjeve, mbetet edhe zhvillimi dhe diversifikimi i tyre. Nevoja e plotësimit të kuadrit ligjor me akte rregullatore për ta bërë sa më të thjeshtë funksionimin e këtyre tregjeve mbetet ndër detyrat themelore të AMF-së. Plotësimi i kuadrit ligjor pritet jo vetëm të modernizojë tregjet, por edhe të krijojë mundësi të tjera për zhvillimin e tyre.

Dixhitalizimi dhe modernizimi të sistemeve të teknologjisë së informacionit gjithashtu, mbetet ndër proceset më kyçe për performancën e tregjeve financiare. Për këtë arsye krijimi i e-shërbimeve për ato kategori që janë më të përdorshme nga qytetarët do të sillte uljen e kostove dhe burokracive për personat e siguruar.

BIBLIOGRAFIA

Volpi A., Le conseguenze della crisi: ipotesi di lettura. 2009.

¹⁷ Raporti I Stabilitetit Financiar I Bankes se Shqiperise 2020

¹⁸ Po aty.

¹⁹ www.amf.gov.al

European Commission: Economic Crisis in Europe: Causes, Consequences and Responses. European Economy 7 (2009). f. 1
http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/publication15887_en.pdf

Gjyli K. Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare. Tirane 2012.

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2020

Bajpai G.N., (2003) Significance of Securities Market in the Growth of an Economy: An Indian Context. Artikull I publikuar nw: http://www.sebi.gov.in/cms/sebi_data/attachdocs/1288676814777.pdf

Choi S.J. and Pritchard A.C., Securities Regulations: The Essentials. Wolters Kluwer Law & Business. Aspen Publishers 2008, f. 53-82; Amadeo K., Securities, Artikull I botuar në portalin ekonomik US Economy. <http://useconomy.about.com/od/glossary/g/securities.htm>; Susan Sushu Yin, A Global Regulatory Framework for Transnational Securities Markets, A thesis submitted for the degree of Doctor of Philosophy in the University of London (Queen Mary College) 2013.

Gitman L.J. and McDaniel C., The Future of Business: The Essentials. Published by South-Western, a part of Cengage Learning, 2009.

Zaho L., Tregjet dhe institucionet financiare. Tirane 2009.

Raporti Statistikor Janar – Shtator 2020, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Raporti I Stabilitetit Financiar I Bankes se Shqiperise 2020

Mekanizmi i solidaritetit në Paktin e ri evropian mbi imigracionin dhe azilin

Dr. Ervis Moçka¹, Dr. Ina Petraj²

¹University "Ismail Qemali" Vlore, Department of Law, ervismocka@gmail.com

²University "Ismail Qemali" Vlore, Department of Law, inapetraj@gmail.com

Abstract

In May 2015, the European Commission presented a 'European Agenda on Migration, with the aim of formulating adequate and harmonized policy responses at EU level. In 2016, the Commission launched an overall reform of the Common European Asylum System with the aim of further harmonizing the EU asylum *acquis*. Two packages of proposals were presented within this reform framework. However, Member States failed to reach an agreement on key regulations, such as the reform of the Dublin system and the Asylum Procedures Regulation. In September 2020, the Commission presented a "New Pact on Migration and Asylum" together with legislative proposals for the reform of the Common European Asylum System. Based on the Commission's communication, the new Pact adopts a "humane approach", promotes solidarity between EU States and adopts "a pool of projected solidarity measures". The aim of this study is to analyse the mechanism of "solidarity" in the new EU Pact on Migration and Asylum.

Key words: asylum, immigration, solidarity, Dublin system

Abstrakt

Në maj 2015, Komisioni Evropian prezantoi një 'Agjendë Evropiane për Migracionin', me qëllim formulimin e politikave dhe masave adekuate dhe të harmonizuara në nivel të BE-së. Në vitin 2016, Komisioni nisi një reformë të përgjithshme të Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të *acquis* të BE-së për azilin. Në këtë kuadër

reformash u prezantuan dy paketa propozimesh. Megjithatë, Shtetet Anëtare nuk arritën një marrëveshje për rregulloret kryesore, si reforma e sistemit të Dublinit dhe Rregullorja e Procedurave të Azilit. Në shtator 2020, Komisioni prezantoi një "Pakt të ri mbi migracionin dhe azilin" së bashku me propozimet legjislative për reformën e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit. Bazuar në Komunikimin e Komisionit, Pakti i ri miraton një "qasje humane", promovon solidaritetin midis shteteve të BE-së dhe miraton "një grup masash solidariteti të parashikuara". Qëllimi këtij studimi është të analizojë mekanizmin e solidaritetit të parashikuar në Paktin e ri të BE-së mbi imigracionin dhe azilin.

Fjalët kyçe: asylum, immigration, solidarity, Dublin system,

1. Hyrje

Pakti evropian mbi migracionin dhe azilin i vitit 2008¹, rezultoi vendimtar për ndryshimin e qasjes së BE-së mbi menaxhimin dhe ndërtimin e një politike të përbashkët evropiane mbi migracionin dhe azilin. Nga një qasje e bazuar kryesisht në sigurinë dhe reduktimin e presionit migrator, BE kaloi në një qasje më të ekuilibruar, që synon përmirsimin e masave të menaxhimit të flukseve migratore, transformimin e imigracionit në një forcë zhvillimi dhe në trajtimin e drejtë të migrantëve të ligjshëm. Kjo qasje u reflektua në Traktatin e Lisbonës, i cili solli një ndryshim të kompetencave dhe procedurave të institucioneve të Bashkimit Evropian përsa i përket vendimmarrjes në çështjet e politikës evropiane për azilin dhe migracionin. Në kuadër të hapësirës së lirisë, drejtësisë dhe sigurisë, BE tashmë si detyrim ka zhvillimin e një politike të përbashkët në disiplinën e azilit, imigracionit dhe kontrollit të kufijve të jashtëm, të bazuar në solidaritetin ndërmjet shteteve anëtare dhe një trajtim të drejtë kundrejt shtetasve të vendeve të treta. Parashikimi i qartë i një politike të përbashkët të imigracionit shënoi një hap të rëndësishëm. Për realizimin e këtij parashikimi traktati zgjeroi kompetencat në disiplinën e imigracionit dhe të azilit, duke autorizuar institucionet e BE-së të miratojnë "standarte uniforme", në dallim nga "standartet minimale" të cilët përcaktonin traktatet e mëparshëm. Në këtë drejtim, duke vënë theksin në politikën e përbashkëta, Traktati i Lisbonës sanksionon miratimin e një "politike të përbashkët lidhur me vizat dhe qëndrimet e tjera afatshkurtra", si dhe "krijimin gradual të një sistemi menaxhimi të integruar për kufijtë e jashtëm". Në mënyrë të ngjashme, Traktati i Lisbonës autorizon institucionet e BE-së për miratimin e "një sistemi evropian të përbashkët azili" bazuar në "standartet uniforme". Duhet theksuar gjithashtu, se politika e azilit, imigracionit dhe kontrollit të kufijve në bazë të parashikimit të nenit 80 TFBE, duhet të bazohet te parimi i solidaritetit dhe ndarjes së përgjegjësisë midis shteteve anëtare. Një parim ky tepër i

rëndësishëm, pasi detyron shtetet anëtare që të përballojnë së bashku flukset dhe kërkesat e azilit, duke ndarë përgjegjësitë. Respektimi i klauzolës së solidaritetit dhe ndarjes së përgjegjësisë eviton që shtetet anëtare të kufijve të jashtëm të përballojnë të vetëm një fluks tepër të madh kërkesash azili, të cilat do të çonin në krizë sistemet e tyre kombëtare të azilit.

2. Rishikimi i kuadrit legjislativ me qëllim krijimin e një politike të përbashkët. Mekanizmat e Dublin III.

Angazhimet e marra nga Këshilli evropian në Paktin evropian mbi imigracionin dhe azilin u konkretizuan në Programin e Stokolmës për periudhën 2010-2014. Realizimi këtij Programi, duke përdorur mjetet juridike të ofruara nga Traktati i Lisbonës, duhet të shënonte dhe fazën përfundimtare, të krijimit të politikës së përbashkët të BE-së mbi imigracionin dhe azilin. Pikërisht në këtë kontekst dhe pas kritikave të shumta, sidomos mbi automatizmin e mekanizmit të Rregullores Dublin II², Komisioni startoj fazën e rishikimit të legjislacionit ekzistues mbi imigracionin dhe azilin me qëllim krijimin e një regjimi të përbashkët. Ndryshimet më të mëdha do të ndodhnin në politikën e azilit, duke u shfuqizuar Direktivat e fazës së parë, të miratuara midis viteve 2001-2005, të cilat parashikonin "standarte" minimale dhe duke miratuar Direktivat e reja të cilat tashmë parashikojnë "standarte uniforme"³.

² Sistemi i Dublinit konsiderohet si guri i themelit të sistemit evropian të përbashkët të azilit. Parimi bazë mbi të cilin mbështetet është i njëjti i parashikuar që në Konventën e Dublinit, më pas në Rregullorën Dublin II dhe nuk do të ndryshohet as nga Rregullorja Dublin III. Sipas këtij parimi, kërkesa e azilit duhet të shqyrtohet nga vetëm një shtet anëtar dhe se përgjegjësia për shqyrtimin e saj bie në radhë të parë mbi shtetin anëtar, i cili konsiderohet përgjegjës për hyrjen dhe qëndrimin e azilkërkuës në territorin e shteteve anëtare.

³ DIRECTIVE 2011/95/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 December 2011 on standards for the qualification of third-country nationals or stateless persons as beneficiaries of international protection, for a uniform status for refugees or for persons eligible for subsidiary protection, and for the content of the protection granted, in *Official Journal of the European Union* L 337/9, date 20.12.2009; DIRECTIVE 2013/32/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013 on common procedures for granting and withdrawing international protection (recast), in *OJEU* L 180/60, 29.06.2013; DIRECTIVE 2013/33/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013 laying

¹ Council of the European Union, "European Pact on Immigration and Asylum", Brussels, September 2007.

Modifikime të rëndësishme do të pësonte dhe mekanizmi i Dublinit parashikuar në Rregulloren nr. 344/2003 e njohur si Dublin II⁴, nëpërmjet zëvendësimit me Rregulloren nr. 604/2013, Dublin III⁵. Rregullorja Dublin III ndryshon disa nga dispozitat e parashikuara për përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës si dhe mënyrat dhe kohën e përcaktimit, ndërkohë që lë të pandryshuara disa nga dispozitat e parashikuara nga Rregullorja e mëparshme. Përsa i përket përcaktimit të shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së azilit, Dublin III nuk e ndryshoi hierarkinë e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e mëparshme si dhe mbetet e pandryshuar dispozita mbi hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm. Përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës është shteti anëtar, në territorin e të cilit vërtetohet se azilkërkuesi ka hyrë në mënyrë të paligjshme. Ndryshimet më të mëdha Rregullorja 604/2013 (Dublin III), i sjell me futjen e afateve përsa i përket rimarrjes në ngarkim të azilkërkuesit nga shteti anëtar kompetent për shqyrtimin e kërkesës si dhe konsideron menaxhimin e mundshëm të përbashkët të emergjencave që vijnë nga një fluks masiv i kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare duke parashikuar "mekanizmin e paralajmërimit të menjëhershëm, përgatitjes dhe menaxhimit të krizës", i cili i jep një rol konkret Zyrës së re Evropiane për Mbështetjen e Azilkërkuesve (EASO)⁶. Kjo e fundit bën rekomandime për shtetin anëtar dhe i kërkon hartimin e një plan veprimi në rastin kur Komisioni konstaton se aplikimi i Rregullores Dublin III mund të pengohet nga një rrezik presioni mbi sistemin e azilit, ose për shkak të

down standards for the reception of applicants for international protection (recast), in OJEU L 180/96, 29.06.2013;

⁴ COUNCIL REGULATION (EC) No 343/2003 of 18 February 2003 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an asylum application lodged in one of the Member States by a third-country national, in OJEU L 50/1, 25.2.2003;

⁵ REGULATION (EU) No 604/2013 of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person (recast), in OJEU L180/31, 29.06.2013

⁶ European Asylum Support Office, krijuar me Rregulloren nr. 439/2010/BE.

problemeve në sistemin e azilit të atij shtetit anëtar. Dispozita në këtë mënyrë sjell një monitorim më efikas nga ana e institucioneve evropiane mbi mospërmbushjet e rënda apo të përsëritura të detyrimeve të pritjes dhe mbrojtjes së azilkërkuesve, të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Por përballja me krizën e shkaktuar nga fluksi i paparashikuar i imigrantëve dhe azilkërkuesve gjatë vitit 2015, nxorri në dukje limitet e funksionimit të sistemit të përbashkët evropian të azilit dhe sidomos mekanizmave të parashikuar në Rregulloren Dublin III. Në përgjigje të këtij fluksi, shtetet anëtare në vend që të aplikojnë mekanizmat e rialokimit të azilkërkuesve, solidaritetit dhe shpërndarjes së përgjegjësisë, iu drejtuan masave kombëtare duke përfshirë dhe mbylljen e kufijve të brendshëm me qëllim kufizimin e askesit në azil. Në këtë mënyrë u minuan sistemet Shengen dhe Dublin mbi të cilat bazohet politika e përbashkët e BE-së⁷.

2. Agjenda Evropiane për Imigracionin (2015).

Drejt Dublin IV, bazuar në parimet e solidaritetit dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësisë.

Me qëllim formulimin e politikave adekuate reagimi ndaj fluksit të lartë të migrantëve drejt BE-së, më 15 Maj të 2015, Komisioni prezantoi Agjendën evropiane për imigracionin⁸. Agjenda parashikonte marrjen e masave të menjëhershme për situatën emergjente si dhe prioritetet strategjike që do të përcaktonin veprimin e BE-së deri në vitin 2020⁹. Në këtë dokument Komisioni paraqiste dhe një "çelës" rishpërndarje të azilkërkuesve midis shteteve anëtare, i cili përcaktonte përqindjen që duhet të merrte çdo shtet anëtar, përlogaritur në bazë të disa kriterëve si, numri i popullsisë, niveli ekonomik (GDP), shkalla e papunësisë si dhe

⁷ European Parliamentary Research Service, "The European Commission's New Pact on Migration and Asylum", Brussels 2021.

⁸ Communication of the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on A European Agenda on Migration, COM(2015) 240.

⁹ COM(2015) 240.

numri i kërkesave të azilit të paraqitura në të shkuarën dhe ato të pranuar.

Si masë emergjente Komisioni propozonte aktivizimin e sistemit të përgjigjes emergjente të parashikuar në nenin 78 (3) TFBE. Skema e përkohshme e rialokimit emergjent e propozuar nga Komisioni, u pasua nga dy vendime të Këshillit. Vendimi i parë nr. 2015/1523¹⁰, i cili parashikonte transferimin brenda një periudhe 2 mujore, të një numri prej 40 mijë azilkërkuessish nga Greqia dhe Italia drejt shteteve të tjera anëtare, u pasua nga vendimi i Këshillit nr. 2015/1601¹¹, i cili parashikonte transferimin e 120 mijë azilkërkuessve për një periudhë 2 vjeçare. Skema e rialokimit e propozuar nga Komisioni u kundërshtua që në fillim nga disa prej shteteve anëtare me në krye Hungarinë dhe Sllovakinë¹², të cilat betejën politike e kthyen në një betejë legale para Gjykatës së Drejtësisë, duke kërkuar anulimin e vendimeve të Këshillit me arsyetimin se neni 78 (3) TFBE nuk ishte baza e duhur ligjore për këto vendime, si dhe për shkelje procedurale, pasi nuk ishte përdorur votimi me unanimitet për miratimin e tyre¹³. Pavarësisht se Gjykata e Drejtësisë nuk u dha të drejtë, këto vende vendosën mos të pranin kuota rialokimi duke u përballur me fillimin e procedurës për mospërbushje të detyrimeve të parashikuar në Traktate, iniciuar nga Komisioni në qershor të 2017.

Në Agjendën për imigracionin, Komisioni përcaktonte 4 shtylla kryesore si prioritetet strategjike, në të cilën duhej të bazohet politika e imigracionit dhe azilit: luftë kundër imigracionit të paligjshëm, përforsim i sigurisë së kufijve të jashtëm të BE-së, përforsim të politikës së përbashkët mbi azilin dhe një politikë të re mbi imigracionin e ligjshëm¹⁴. Me

qëllim realizimin e këtyre prioritetëve në Agjendën evropiane të imigracionit, Komisioni parashikonte dhe aksionet themelore për tu ndërmarrë, ku një theks i veçantë vihej te kompletimi i sistemit të përbashkët evropian të azilit nëpërmjet rishikimit të kuadrit ligjor (Dublin III) dhe njohjes reciproke të vendimeve mbi azilin.

Në bazë të prioritetëve të përcaktuara në Agjendën evropiane për imigracionin, në 2016 Komisioni do të niste reformimin e sistemit të përbashkët evropian të azilit, me qëllim krijimin e një politike të azilit më humane, më të drejtë dhe më efektive si dhe për një menaxhim më të mirë të imigracionit të ligjshëm¹⁵. Për Komisionin, kriza e fluksit të azilkërkuessve vuri në dukje limitet e sistemit të përbashkët evropian mbi azilin dhe në veçanti të sistemit të Dublinit, i cili nuk ishte krijuar për të garantuar një shpërndarje të qëndrueshme të përgjegjësisë kundrejt azilkërkuessve brenda BE-së¹⁶. Jo vetëm mekanizmi i Dublin III rezultoi i papërshtshëm për të përballuar krizën por sistemi i përbashkët i azilit rezultoj se karakterizohej dhe nga diferenca të theksuara në trajtimin e azilkërkuessve nga një shtet në një shtet tjetër anëtar, në veçanti për sa i përket afateve të shqyrtimit të kërkesës dhe kushteve të pritjes, gjë që çon në lëvizjen e azilkërkuessve drejt vendeve anëtare me sistem azili më të mirë. Këto diferenca vinë si pasojë e dispozitave fakultative dhe jo detyruese të Direktivave nr. 2013/33/EU dhe nr. 2013/32/EU mbi procedurat dhe pritjen¹⁷. Limite gjithashtu paraqet dhe Direktiva nr. 2011/95/EU mbi kualifikimin e statusit të refugjatit, e cila pavarësisht se përmban dispozita mbi dhënjen e statusit dhe nivelin e mbrojtjes, në praktikë nuk ka mundur të eliminojë dhënjen e vendimeve të ndryshme për azilkërkuess të cilit vinin nga e njëjta pozitë dhe nga i njëjti vend origjine.

Me qëllim aplikimin korrekt të sistemit të Dublinit, gjatë vitit 2016, Komisioni do të paraqiste 2 paketa propozimesh për reformimin

¹⁰ Council Decision (EU) 2015/1523 of 14 September 2015 establishing provisional measures in the area of international protection for the benefit of Italy and of Greece.

¹¹ Council Decision (EU) 2015/1601 of 22 September 2015 establishing provisional measures in the area of international protection for the benefit of Italy and Greece

¹² KRASSTEV, Ivan. "After Europe", University of Pennsylvania Press, 2017: p.46.

¹³ CJEU, Slovakia v Council, C-643/15 and CJEU, Hungary v Council, C-647/15.

¹⁴ COM(2015) 240.

¹⁵ Communication from the Commission to the European Parliament and the Council towards a reform of the Common European Asylum System and enhancing legal avenues to Europe. COM(2016) 197 final.

¹⁶ COM(2016) 197 final.

¹⁷ COM(2016) 197 final.

e sistemit të përbashkët evropian të azilit, në të cilën parashikonte: riformulimin e Rregullore Dublin III¹⁸; rishikimin e Rregullore EURODAC¹⁹ e cila ka krijuar sistemin e krahasimit të shenjave të gishtërinjve; propozim Rregullore mbi krijimin e Agjensisë evropiane të azilit (EUAA) që shfuqizon Rregulloren nr. 439/2010 e cila ka krijuar Zyrën evropiane për mbështetjen e azilkërkuesve (EASO)²⁰; riformulimin e Direktivës 2013/33 mbi normat e pritjes së azilkërkuesve²¹; propozim Rregullore mbi kualifikimin e statusit të refugjattit dhe status uniform mbrojtjeje duke shfuqizuar Direktivën Kualifikime nr. 2011/95/EU²²; propozim Rregullore mbi përcaktimin e një procedure të përbashkët mbi mbrojtjen ndërkombëtare duke shfuqizuar në këtë mënyrë Direktivën e Procedurave nr. 2013/32/EU²³, si dhe modifikimin e Rregullore

nr. 516/2014 e cila krijon kuadrin ligjor mbi zhvendosjen e azilkërkuesve²⁴. Deri në fund të 2019-ës, Parlamenti evropian dhe Këshilli si bashkëvendimarrës do të gjenin dakortësinë mbi të gjitha propozimet me përjashtim të propozimit mbi rishikimin e Rregullore Dublin III dhe propozimit të Rregullore mbi përcaktimin e procedurës së përbashkët e cila zëvendësonte Direktivën e Procedurave. Kundërshtitë më të mëdha vinin në Këshill nga disa prej shteteve anëtare të cilët vazhdojnë të refuzojnë çdo lloj mekanizmi të detyrueshëm në lidhje me rishpërndarjen e azilkërkuesve. Në fakt në propozimin e rishikimit të Dublin III, pavarësisht se nuk ndryshohen kriteret ekzistuese të përcaktimit të shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së azilkërkuesit, i cili në shumicën e rasteve është shteti ku hyn për herë të parë, Komisioni propozoi përmirsimin e sistemit të Dublinit nëpërmjet plotësimit me një mekanizëm korrigjues alokimi (fairness mechanism)²⁵. Sipas propozimit të Komisionit ky mekanizëm aktivizohet automatikisht në momentin kur një shtet anëtar përballet me një presion disproporcional mbi azilin. Propozohet një "çelës" referimi i përlllogaritur në dy kritere: numri i popullsisë dhe prodhimi i brendshëm bruto (GDP)²⁶, i cili tregon kuotën e azilkërkuesve që do të merrte çdo shtet anëtar mbi kuotën e përgjithshme të aplikimeve në nivel evropian, nëse ndarja do të bëhej në bazë të madhësisë së shteteve dhe fuqisë ekonomike të tyre. Në momentin që një shtet anëtar do të përballej me një disproporcion të kërkesave të azilit, të përcaktuar në 150% mbi kuotën e referimit, aktivizohet automatikisht mekanizmi i rialokimit dhe të gjitha aplikimet e reja të depozituara në atë shtet anëtar, pas aktivizimit të mekanizmit, do tu shpërndaheshin shteteve të tjera anëtare të cilat kanë një numër aplikimesh nën numrin e përcaktuar në çelësin e referencës²⁷. Në këtë mënyrë Komisioni bazonte

¹⁸ COM(2016) 270 final., Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person (recast).

¹⁹ COM(2016) 272 final., Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on the establishment of 'Eurodac' for the comparison of fingerprints for the effective application of [Regulation (EU) No 604/2013 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person], for identifying an illegally staying third-country national or stateless person and on requests for the comparison with Eurodac data by Member States law enforcement authorities and Europol for law enforcement purposes;

²⁰ COM(2016) 271 final., Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on the European Union Agency for Asylum (EUAA) and repealing Regulation (EU) No 439/2010.

²¹ COM(2016)465 Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL laying down standards for the reception of applicants for international protection (recast).

²² COM(2016)466, Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on standards for the qualification of third-country nationals or stateless persons as beneficiaries of international protection, for a uniform status for refugees or for persons eligible for subsidiary protection and for the content of the protection granted and amending Council Directive 2003/109/EC of 25 November 2003 concerning the status of third-country nationals who are long-term residents

²³ COM(2016)467, Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL establishing a common procedure for international protection in the Union and repealing Directive 2013/32/EU.

²⁴ COM(2016)468, Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL establishing a Union Resettlement Framework and amending Regulation (EU) No 516/2014 of the European Parliament and the Council.

²⁵ Radjenovic A., Briefing on the Reform of the Dublin System, EPRS, European Parliament, March 2019.

²⁶ Neni 35 i Rregullore së propozuar, COM(2016) 270 final.

²⁷ Neni 36 i Rregullore së propozuar, COM(2016) 270 final.

reformimin e rregullores Dublin III në parimet e solidaritetit dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësive midis shteteve anëtare. Ndërkohë mos dakortësi në Këshill u evidentuan dhe mbi propozim Rregulloren mbi përcaktimin e procedurës së përbashkët e cila zëvendësonte Direktivën Procedura. Kjo Rregullore synonte të vendoste një procedurë të përbashkët, të drejtë dhe efikase për mbrojtjen ndërkombëtare duke hequr diferencat që ekzistojnë në procedurat kombëtare të cilat bazohen në standarte minimale të përcaktuara në Direktivën Procedura nr. 2013/32/EU. Me harmonizimin e plotë të legjislacionit nëpërmjet Rregullores eliminohen diferencat në procedura si dhe duke ofruar garanci procedurale të njëjta reduktohen dallimet në normat e njohjes dhe dekurajohen lëvizjet dytësore nga një shtet anëtar në tjetrin²⁸.

4. Mekanizmat e solidaritetit në Paktin e ri mbi imigracionin dhe azilin .

Me qëllim tejkalimin e konflikteve që penguan reformën e vitit 2016, më 23 shtator 2020, Komisioni Evropian prezantoi Paktin e ri për Migracionin dhe Azilin, së bashku me propozimet legjislative për reformën e sistemit të përbashkët evropian të azilit. Pakti i ri miraton një "qasje humane", promovon solidaritetin ndërmjet shteteve të BE-së dhe miraton "një grup masash të parashikuara solidariteti"²⁹. Pakti i ri vë theksin mbi parimin e solidaritetit, për të cilin të gjithë shtetet anëtare duhet të kontribuojnë mbi baza kostante me qëllim që asnjë shtet anëtar të përballojë një përgjegjësi joproporcionale³⁰. Pikërisht duke u mbështetur te parimi i solidaritetit dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësive pakti i ri synon të promovojë një qasje të integruar që synon të adresojë, brenda një kuadri të vetëm dhe të koordinuar, politikat për azilin, migrimin, riatdhesimin, mbrojtjen e kufijve të jashtëm, dhe marrëdhëniet me vendet e treta, duke shmangur

²⁸ Kris Pollet, 'All in vain? The fate of EP positions on asylum reform after the European elections', EU Immigration and Asylum Law and Policy blog, 23 May 2019.

²⁹ Communication COM(2020) 609 final from the Commission of 23 September 2020 on a New Pact on Migration and Asylum.

³⁰ COM(2020) 609 final

përdorimin e zgjidhjeve të rastësishme të rregulluara rast pas rasti, të cilat kanë karakterizuar menaxhimin e flukseve dhe bashkëpunimin midis shteteve anëtare në vitet e fundit³¹. Në këtë mënyrë, rihapet menjëherë rruga e reformave, duke rikuperuar një pjesë të propozimeve dhe negociatave të zhvilluara që nga momenti i propozimeve të paketës së reformave të vitit 2016. Në disa raste, si ai i Rregullores EUODAC³² dhe Rregullores mbi vendosjen e një procedure të përbashkët³³ Komisioni paraqet ndryshime në propozimin e avancuar. Në të tjera, siç është modifikimi i të ashtuquajturës Rregullorja Dublin IV me një Rregullore mbi manaxhimin e azilit dhe migracionit ³⁴, Rregullorja që krijon një procedurë para-hyrëse (*screening*) ³⁵ dhe Rregullorja mbi menaxhimin e krizave në fushën e migracionit dhe azilit³⁶, paraqiten propozime tërësisht të reja, duke marrë parasysh pikat e marrëveshjes dhe ato të kontrastit të shfaqura qartë midis shteteve anëtare në vitet e fundit. Këtyre u shtohen edhe aktet pjesë e paketës së vitit 2016, për të cilat Komisioni nuk ka propozuar asnjë ndryshim dhe kërkon miratimin e menjëhershëm (Rregullorja mbi kualifikimin dhe statusin uniform të refugjatit³⁷, Direktiva mbi standartet e pritjes³⁸, Rregullorja mbi Agjensinë evropiane të azilit³⁹, Rregullorja

³¹ Di Pascale A., "Il nuovo Patto per l'immigrazione e asilo: scontentare tutti per accontentare tutti", in Eurojus.it.

³² Proposal COM(2020) 614 final.

³³ Amended proposal COM(2020) 611 final of the European Commission of 23 September 2020 for a Regulation of the European Parliament and the Council establishing a common procedure for international protection in the Union and repealing Directive 2013/32/EU.

³⁴ Proposal COM(2020) 610 final of the European Commission of 23 September 2020 for a Regulation of the European Parliament and of the Council on asylum and migration management and amending Council Directive (EC) 2003/109 and the proposed Regulation (EU) XXX/XXX [Asylum and Migration Fund]

³⁵ Proposal COM(2020) 612 final of the European Commission of 23 September 2020 for a Regulation of the European Parliament and of the Council introducing a screening of third country nationals at the external borders and amending Regulations (EC) n. 767/2008, (EU) 2017/2226, (EU) 2018/1240 and (EU) 2019/817.

³⁶ Proposal COM(2020) 613 final for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL addressing situations of crisis and force majeure in the field of migration and asylum

³⁷ Proposal COM(2016)466 final.

³⁸ Proposal COM(2016)465 final.

³⁹ Proposal COM(2016) 271 final.

mbi zhvendosjen ⁴⁰ dhe Direktiva mbi riatdhesimet e propozuar në vitin 2018⁴¹).

Një nga risitë e Paktit është pikërisht propozimi i mekanizmit të "solidarititetit evropian". Një bllok i rëndësishëm i akteve legislative të parashikuara me Paktin e ri propozon ndryshime në mekanizmat e ndarjes së përgjegjësive dhe solidaritetit, duke përfshirë zbatimin e tyre në kohë krize. Në veçanti, Rregullorja e re mbi menaxhimin e azilit dhe imigracionit e cila shfuqizon Rregulloren Dublin III dhe tërheq propozimin e vitit 2016 për një riformulim të saj (Dublin IV), fut rregulla më të thjeshta dhe më efikase për një ndarje të qëndrueshme të përgjegjësive për azilkerkuesit në të gjithë BE-në, dhe e plotëson me një mekanizëm solidariteti "fleksibël" dhe "gjithëpërfshirës". Mekanizmi i ri parashikon që një shtet anëtar i cili gjendet nën presionin e kërkesave të azilit duhet të ndihmohet nga shtetet e tjera anëtare në një nga mënyrat midis: rialokimit, sponsorizimit të riatdhesimeve dhe ngritjes së kapaciteteve (*capacity building*)⁴². Në këtë mënyrë solidariteti shprehet në tre forma, ku secili shtet anëtar mund të zgjedhë mënyrën se si do të kontribuojë. Si garant i realizimit të parimit të solidaritetit del Komisioni i cili mban pushtetin e përcaktimit të kuotave dhe mënyrës së mbështetjes, në rast se ofertat nga shtetet anëtare rezultojnë të pamjaftueshme ⁴³. Mekanizmi aktivizohet në momenti që Komisioni vlerëson, pas kërkesës së një shteti anëtar apo në bazë të informacioneve të disponueshme, se shteti anëtar gjendet përballë një presioni migrator. Vlerësimi i Komisionit i cili bazohet në një sërë kriteresh të parashikuara në nenin 50 të Rregullores së propozuar, i paraqitet brenda një muaj Këshillit dhe Parlamentit evropian, në formën e një relacioni në të cilin tregohen kapacitetet dhe nevojat e shtetit anëtar për të përballuar presionin migrator, si dhe masat e përshtatshme që duhen marrë nga shteti nën presion migrator

dhe nga shtetet e tjerë anëtare⁴⁴. Këta të fundit brenda dy javësh nga paraqitja e relacionit të Komisionit duhet të paraqesin planin e përgjigjes së solidaritetit, në të cilin tregohet se si do të kontribuojnë duke përzgjedhur një apo më shumë nga tre format e solidaritetit të parashikuara (rialokim, sponsorizim të riatdhesimeve apo *capacity building*), duke përcaktuar dhe mënyrat e detajuara dhe kalendarin e realizimit. Nëse Komisioni konkludon se kontributi i përcaktuar në planet e solidaritetit është i pamjaftueshëm, mbledh Forumin e solidaritetit në të cilin shtetet anëtare duhet të paraqesin planet e rishikuara të solidaritetit. Brenda dy javësh nga paraqitja e planeve të solidaritetit, Komisioni nxjerr një akt ekzekutiv në të cilin përcaktohet kontributin e solidaritetit që përfiton shteti anëtar nën presion migrator dhe kontributin që shtetet anëtare ofrojnë sipas mënyrës që kanë përzgjedhur. Komisioni në këtë mënyrë përshtat planet e solidaritetit të propozuara nga shtetet duke përcaktuar numrin total të personave që duhet të zhvendosen dhe numrin total të personave që pësojnë riatdhesimin e sponsorizuar. Përlllogaritja e numrit të personave për rialokim apo riatdhesim që i përket çdo shteti anëtar bëhet në bazë të një "çelësi" bazuar në dy kriteret: numri i popullsisës dhe GDP e çdo shteti anëtar. Shtetet anëtare të cilat kanë ofruar solidaritet vetëm me mënyrën e sponsorizimit të riatdhesimeve, duhet ta realizojnë këtë brenda 8 muajve, në të kundërt duhet të transferojë personat e interesuar brenda territorit të tyre⁴⁵.

Krahas regjimit të solidaritetit nën presion migrator të përshkruar, Rregullorja e propozuara parashikon dhe dy regjime të tjera të solidaritetit, bazuar në rrethanat dhe sfidat migratore me të cilat shtetet anëtare mund të përballen. Regjimin e solidaritetit vullnetar⁴⁶, ku çdo shtet anëtar pas kërkesës së një shteti anëtar apo me iniciativë të vetën mund të ofrojë mbështetjen e tij, dhe regjimi i solidaritetit në rastet e zbarkimit pas operacioneve të kërkimshpëtimit. Mekanizmi i solidaritetit në rastet e

⁴⁰ Proposal COM(2016) 468 final.

⁴¹ Proposal COM(2018)634 final.

⁴² Art. 45, Proposal COM(2020) 610 final

⁴³ "Il nuovo Patto sulla migrazione e l'asilo presentato dalla Commissione europea. L'analisi di Asilo in Europa", in <https://www.asiloineuropa.it/wpcontent/uploads/2020/10/Analisi-nuovo-patto-ue-immigrazione-e-asilo.pdf>

⁴⁴ Art. 51, Proposal COM(2020) 610 final.

⁴⁵ Art. 55, Proposal COM(2020) 610 final.

⁴⁶ Art. 56, Proposal COM(2020) 610 final.

kërkim-shpëtimimit është mjaft kompleks dhe kalon në disa faza⁴⁷. Dhe në fund, një regjim specifik solidariteti parashikohet në situata krizash nga propozim Rregullorja mbi situatat e krizave dhe forcës madhore⁴⁸. Qëllimi është krijimi i procedurave të solidaritetit dhe mekanizmat për të ofruar një përgjigje të shpejtë në rrethana që kërkojnë veprime urgjente⁴⁹. Mekanizmi i solidaritetit në krizë nxitet nga një akt zbatues i miratuar nga Komisioni pas një "kërkese të arsyetuar" nga një shtet anëtar. Veçanërisht, përcaktohen afate kohore të shkurtuara të aktivizimit të mekanizmit të detyrueshëm të solidaritetit dhe prezantimit të planeve të reagimit. Në situata krize, solidariteti mund të ofrohet vetëm nëpërmjet rialokimit dhe sponsorizimeve të riadhesimit për të cilin afatet e realizimit shkurtohen në 4 muaj.

5. Konkluzione

Pakti i ri mbi imigracionin dhe azilin paraqet elementë vazhdimësie dhe disa risi thelbësore për sa i përket mekanizmave të solidaritetit. Propozimi mbi Rregulloren e re mbi menaxhimin e azilit dhe migracionit ruan parimin sipas të cilit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së azilit është vendi i hyrjes së parë, por nëpërmjet saj tentohet të tejkalohen divergjencat e thella ekzistuese në lidhje me sistemin e Dublinit, duke futur një skemë më fleksibël. Solidariteti shihet si një mekanizëm korrigjues i rregullave mbi caktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së azilit. Mekanizmat e reja të solidaritetit futen si element strukturor të përcaktuara në dispozita dhe procedura të qarta, ndryshe nga si ka funksionuar, ku vendimet e rialokimit janë marrë si rezultat i politikës vendimarrëse të Këshillit, si masa emergjente në zbatim të nenit 78(3) TFEU⁵⁰. Nëpërmjet kësaj qasje të re të solidaritetit e cila përshkruhet si

gjithëpërfshirëse dhe fleksibël, synohet të arrihet që ardhjet e parregullta të refugjatëve trajtohen nga BE-ja në tërësi dhe ku çdo shtet anëtar do të duhet të kontribuojë në solidaritet. Fleksibiliteti që u ofrohet shteteve anëtare në zgjedhjen autonome të masave dhe mënyrës se si do të kontribuojnë, bëhet për të balancuar natyrën e detyrueshme të mekanizmit të solidaritetit, i cili aplikohet në momentin kur Komisioni deklaron ekzistencën e një situatë presioni apo krize migratore⁵¹. Por pikërisht mbi fleksibilitetin në të cilin bazohet mekanizmi i ri vihen re dhe rezervat më të mëdha për funksionimin e parimit të solidaritetit si një parim strukturor dhe një detyrim juridik parashikuar në nenin 80 TFEU. Kjo për faktin se shumë prej shteteve anëtare kanë shprehur se nuk janë të gatshëm të zgjedhin opsionin e parë, atë të rialokimit të azilkërkuesve, por dhe sepse bazuar në eksperiencën e krizës së fundit ku rialokimi u bë i detyrueshëm nga Vendimet e Këshillit, rezultati ishte shumë i ulët dhe disa prej shteteve anëtare refuzuan të përmbushnin detyrimin e vendosur nga Këshilli për të marrë azilkërkues⁵². Po të shtohet dhe fakti se opsioni i dytë ai i sponsorizimit të riadhesimeve, ndryshe nga kompensimi financiar, është një opsion i cili nuk ndihmon rialokimin, atëherë nuk ka shumë arsye të besohet se një sistem që rialokimin e kthen në opsion mund të funksionojë⁵³. Megjithatë në përfundim, është e nevojshme në çdo rast të vlersohet qasja e re në Paktin e miratuar, e cila tenton të parandalojë vazhdimin e ngërçit që ka karakterizuar prej kohësh reformat e azilit dhe imigracionit⁵⁴ dhe të theksohet se ndoshta solidariteti i përshkruar nga Pakti nuk përfaqëson modelin më të mirë,

⁵¹ Penasa S., "Il Nuovo Patto e l'idea di solidarietà: principio fondativo del sistema europeo di asilo o metodo di allocazione delle responsabilità tra Stati membri?", in *Accademia Diritto e Migrazioni*, Nëntor 2020.

⁵² Rasti i Polonisë, Hungarisë dhe Republikë Çeke, ndaj të cilave pas ankesës së Komisionit ka dhe një vendim të Gjykatës së Drejtësisë në të cilin kërkohet përmbushja e detyrimit (Judgment in Joined Cases C-715/17, C-718/17 and C-719/17 Commission v Poland, Hungary and the Czech Republic, April 2020).

⁵³ The new Pact on Migration and Asylum, EuroMedRights, Bruxelles 2001, fq. 25.

⁵⁴ Thym D., *European Realpolitik: Legislative Uncertainties and Operational Pitfalls of the 'New' Pact on Migration and Asylum*, in "Special Collection on the 'New' Migration and Asylum Pact", Shtator 2020.

⁴⁷ Art. 47-49, Proposal COM(2020) 610 final.

⁴⁸ COM(2020) 613 final Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL addressing situations of crisis and force majeure in the field of migration and asylum

⁴⁹ COM(2020)609, fq. 10.

⁵⁰ European Parliamentary Research Service, "The European Commission's New Pact on Migration and Asylum", Brussels 2021, fq. 86.

por më të mirën e modeleve të mundshme, duke pasur parasysh kushtet politike, institucionale dhe sociale që karakterizojnë aktualisht marrëdhëniet midis institucioneve evropiane dhe atyre shtetërore⁵⁵.

Referencat

Di PASCALE A., "Il nuovo Patto per l'immigrazione e asilo: scontentare tutti per accontentare tutti", in Eurojus.it.

EPRS (European Parliamentary Research Service), "The European Commission's New Pact on Migration and Asylum", Brussels 2021.

EuroMedRights, "The new Pact on Migration and Asylum", Bruxelles 2001.

KRASTEV, Ivan. "After Europe", University of Pennsylvania Press, 2017

POLLET Kris., 'All in vain? The fate of EP positions on asylum reform after the European elections', EU Immigration and Asylum Law and Policy blog, 23 May 2019.

PENASA S., "Il Nuovo Patto e l'idea di solidarietà: principio fondativo del sistema europeo di asilo o metodo di allocazione delle responsabilità tra Stati membri?", in *Accademia Diritto e Migrazioni*, Nëntor 2020.

RADJENOVIC A., *Briefing on the Reform of the Dublin System*, EPRS, European Parliament, March 2019.

THYM D., *European Realpolitik: Legislative Uncertainties and Operational Pitfalls of the 'New' Pact on Migration and Asylum*, in "Special Collection on the 'New' Migration and Asylum Pact", Shtator 2020

"Il nuovo Patto sulla migrazione e l'asilo presentato dalla Commissione europea. L'analisi di Asilo in Europa", in <https://www.asiloineuropa.it/wpcontent/uploads/2020/10/Analisi-nuovo-patto-ue-immigrazione-e-asilo.pdf>

COM(2015) 240

COM(2016) 197 final

Proposal COM(2016) 466 final.

Proposal COM(2016) 465 final.

Proposal COM(2016) 271 final.

Proposal COM(2016) 468 final.

Proposal COM(2018) 634 final.

COM(2016) 467 final.

COM(2016) 270 final

COM(2016) 272 final

COM(2020) 613 final

COM(2020) 609 final.

Proposal COM(2020) 610 final

Amended proposal COM(2020) 611 final

Proposal COM(2020) 612 final

Proposal COM(2020) 613 final

Proposal COM(2020) 614 final.

COUNCIL DECISION (EU) 2015/1523 of 14 September 2015 establishing provisional measures in the area of international protection for the benefit of Italy and of Greece.

COUNCIL DECISION (EU) 2015/1601 of 22 September 2015 establishing provisional measures in the area of international protection for the benefit of Italy and Greece

DIRECTIVE 2011/95/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 December 2011 on standards for the qualification of third-country nationals or stateless persons as beneficiaries of international protection, for a uniform status for refugees or for persons eligible for subsidiary protection, and for the content of the protection granted, in Official Journal of the European Union L 337/9, date 20.12.2009;

DIRECTIVE 2013/32/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013 on common procedures for granting and withdrawing international protection (recast), in OJEU L 180/60, 29.06.2013; DIRECTIVE 2013/33/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013 laying down standards for the reception of applicants for international protection (recast), in OJEU L 180/96, 29.06.2013;

COUNCIL REGULATION (EC) No 343/2003 of 18 February 2003 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an asylum application lodged in one of the Member States by a third-country national, in OJEU L 50/1, 25.2.2003;

⁵⁵ Penasa S., "Il Nuovo Patto... cituar, fq. 6.

REGULATION (EU) No 604/2013 of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 establishing the criteria and mechanisms for determining the Member State responsible for examining an application for international protection lodged in one of the Member States by a third-country national or a stateless person (recast), in OJEU L180/31, 29.06.2013

Legjislacioni evropian mbi markën tregtare

Dr. Belinda HALILAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Vlorë/Shqipëri, belinda2012halilaj@gmail.com

Abstrakt

Marka tregtare është një shenjë që dallon mallrat ose shërbimet e prodhuara apo të ofruara nga një ndërmarrje nga ato të ndërmarrjeve të tjera. Fjalët, shkronjat, numrat, vizatimet, fotografit, format, ngjyrat, logot, etiketat ose kombinime të përdorura, mund të konsiderohen një markë tregtare (1). Në disa vende, sloganet konsiderohen marka tregtare dhe mund të regjistrohen si të tillë në zyrat kombëtare. Qëllimi i një marke tregtare është t'i ofrojë konsumatorit mundësinë për të identifikuar një produkt nga produktet identike ose produkte të ngjashme të vendosura nga kompani të tjera në treg. Që kompania të dallojë mallrat dhe produktet e veta nga ato të konkurrentëve, markat tregtare luajnë një rol kryesor në etiketimin dhe strategjitë e kompanive mbi marketingun, duke kontribuar në përcaktimin e imazhit dhe reputacionin e produkteve të kompanisë në sytë e konsumatorëve (1). Ligji Evropian për markat tregtare mbështetet në dy struktura: Direktiva për markat tregtare (2) dhe Rregullorja e Komuniteti për markat tregtare (3). Direktiva për markat tregtare ka si synim përafrimin e ligjislacionit të Shteteve Anëtare, për të lejuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, Rregullorja e Komuniteti për markat tregtare parashikonte masa për të krijuar një të drejtë të unifikuar në të gjithë Shtetet Anëtare.

Fjalë kyçe: *markë tregtare, legjislacion evropian, subjekt regjistruar, shenjë dalluese.*

Abstract

Trademark is a sign that distinguishes goods or service, produced or offered from one company to other. Words, numbers, pictures, photos,

colors, labels or combination used can be considered a trademark. In some countries slogans considered trademarks and may be registered in national offices.

The purpose of a trademark is to offer consumers the opportunity to identify a product from identical product or similar products placed in market from other company. That company to identify themselves from other company, trademarks play a special role in labeling and strategy of company on marketing, contributing in image and reputation of company product's in the eyes of consumers.

European law for trademark supported on two structures: Directive for trademark and Regulation of Community for trademark. The directive for trademark has objective to approximate the law of the Member States to allow the free movement of goods and services, Regulation of Community for trademark take measure for to create unified right in all Member State.

Key words: *trademark, european law, subject registration, distinguish sign.*

Vlera e Markave

Një markë e zgjedhur me kujdes është një pasuri e vlefshme për biznesin dhe kompanitë e mëdha. Disa prej markave më të famshme botërore si Coca-Cola apo IBM tejkalojnë vlerën e 50 miliardë dollarë secili. Kjo është për shkak se konsumatorët vlerësojnë markat tregtare, reputacionin dhe imazhin e tyre është i dëshiruar. Prodhuesit produktet e tyre i shoqërojnë me shenjën e firmës, konsumatorët janë të gatshëm

për këto produkte të paguajnë më shumë në bazë të markës tregtare që ata njohin dhe që plotëson pritjet e tyre. Reputacioni i mire i një marke është baza për zhvillimin e konkurrencës dh rritjes të cilësisë së produkteve. Marka mund:

- 1) të sigurojë që konsumatorët të dallojë ato në mes të produkteve të tjera;
- 2) u mundëson kompanive të dallojnë produktet e tyre;
- 3) janë një mjet marketingu dhe bazë për ndërtimin e imazhit të markës;
- 4) mund të licencohen për të siguruar një burim të drejtpërdrejtë të ardhurash nëpërmjet honorareve;
- 5) janë një komponent i rëndësishëm i marrëveshjeve;
- 6) mund të jetë një aset i vlefshëm i biznesit;
- 7) inkurajojë kompanitë të investojnë në mirëmbajtjen ose përmirësimin e cilësisë së produktit;
- 8) mund të jenë të dobishme për marjen e financimit.

Metodologjia

Për zhvillimin e këtij punimi shkencor kam përdorur disa metoda kërkimi si: historike, përshkruese, shpjeguese, analitike. Këto metoda gjenden të përziera në punim.

Mbrojtja e markave të regjistruara

Mbrojtja mund të garantohet për markat e regjistruara ose në disa vende edhe vetëm nëpërmjet përdorimit të tyre. Kur marka vetëm përdoret ajo duhet të regjistrohet, regjistrimi i markës është mënyra për të garantuar mbrojtjen e saj, në rast konflikti ose në rastin e produkteve të ngjashme. Shumë njerëz besojnë se duke regjistruar biznesin e tyre, emri i saj tregtar në biznes do të jetë automatikisht i mbrojtur si markë tregtare.

Farmaceutikë: Hoffmann-La Roche kundër Centrafarm (4).

Valiumi, një bar qetësues i familjes benzodiazepinës u hodh në treg nga Hoffmann-La Roche në vitin 1963. Në kulmin e saj në vitin 1978 rreth 2.3 miliardë tableta ishin shitur. Fama e saj si një kurë për ankthit ishte përhapur shumë

shpejt, ngjarjet që çuan çështjen në gjykatë u zhvilluan gjatë viteve 1970, kur Valium ishte ende nën mbrojtjen e patentës. Valium u tregtuar në Gjermani nga Hoffmann-La Roche për individët në paketat me 20 ose 50 tableta dhe për spitalet në paketat që përmbajnë 100 apo 250 tableta. **Filial i saj britanik** i cili kishte prodhuar të njëjtin produkt, e kishte tregtuar atë në paketa prej 100 apo 500 tableta me çmime më të ulta se ato në Gjermani. **Një kompani holandeze Centrafarm** kishte importuar një sasi valiumi në Holandë, të cilën e kishte blerë në Britani në paketa origjinale. Ilaçet më pas ishin ripaketuar në paketa me 1000 tableta, të cilat cënuan tregtinë Hoffmann-La Roche-si mark, e shoqëruar sëbashku me një njoftim që i kishte dhënë emrin dhe adresën ilaçit si shitës i tij. Centrafarm filloi marketingun e këtyre paketave në Gjermani, si importues paralele, i cili kishte shfrytëzuar diferencat e çmimeve, duke i blerë më lirë dhe rishitur më pas me një fitim më të lart. *Sistemet ligjore kombëtare të pronësisë intelektuale kanë efekt territorial për mbrojtjen e markës tregtare, por pyetja që ngrihet në këtë rast është se si duhet të përgjigjet Komuniteti në një situatë të tillë?* Mbjtësi i të drejtës, Hoffmann-La Roche, ishte i shqetësuar për konkurrencen e padëshiruar në shpërndarjen e produktit të vetë, sepse kjo kishte ndikim në çmim. Ai ishte gjithashtu i shqetësuar për integritetin dhe imazhin e markës së tij tregtare. Ripaketimi përbënte një rrezik për gjëndjen origjinale të produktit si dhe për mënyrën në të cilën ishte paraqitur te konsumatori. Së fundi, Hoffmann-La Roche ishte i shqetësuar se aktiviteti Centrafarm-së mund ta bëjë të vështirë identifikimin e ilaçeve të falsifikuara. Marka tregtare është një pjesë e rëndësishme e garancisë për konsumatorin, ripaketimi paraqet kërcënim të qartë për këtë garanci, pasi produkti nuk shkon direkt nga prodhuesi të konsumatorit. Nëse produkti është dëmtuar gjatë procesit të ripaketimit, kjo i jep konsumatori të drejtë të kërkoj dëmshpërblim. *Importuesi paralele* është i motivuar nga fitimi dhe do të preferojnë një mjedis sa më pak ligjor dhe rregullator. Komuniteti kërkon një treg të vërtetë farmaceutikë, që do të thotë një treg konkurrues pa barriera ndaj tregtisë. Mbrojtja e konsumatorit është gjithashtu një prioritet i lartë. Përveç kësaj, Komuniteti duhet të mbajë një reputacion si një vend i mirë për kompanitë për

të bërë biznes, e cila përfshin duke ofruar mbrojtjen e duhur për Markat Tregtare. GJED vendosi se funksioni thelbësor i një marke tregtare ishte të garantonte konsumatorin për markën e shënuar në produkt, jo vetëm mbi origjinën e produktit, por të jenë të sigurt se produkti nuk ka qenë subjekt i ndërhyrjes nga një person i tretë, pa autorizimin e pronarit të markës tregtare. Prandaj GJED ka përcaktuar tre kushte të cilat një importues paralele është i detyruar ti plotësoj:

1.ripaketimi duhet të jetë kryer në një mënyrë që nuk e prek gjendjen origjinale të produktit;

2.pronarit të markës duhet t'i jepet njoftim paraprak mbi marketingut e produktit te ripaketuar;

3.paketimi i ri duhet të tregojë personin, nga i cili janë kryer nderhyrjet.

Është e rëndësishme që të të bëjmë dallimin midis markës tregtare dhe emrit te firmës. **Një emër tregtar** është emri i plotë i biznesit, si: "Blackmark International Ltd "dhe ajo identifikon kompaninë, ajo shpesh përfundon me Ltd, Inc ose shkurtesa të tjera të ngjashme duke treguar karakterin ligjor të kompanisë. **Një markë tregtare**, është shenja që dallon produktin (et) e kompanis. Një kompani mund të ketë marka tregtare të ndryshme, për shembull: Blackmark International Ltd mund të shesë një prej produkteve të saj si BLACKMARK ose një tjetër si REDMARK (1). Kompanitë mund të përdorin një markë të veçantë që të identifikojnë të gjitha produktet e saj, një varg të veçantë të produkteve apo një lloj të veçantë të produkteve. Disa kompani mund të përdorin gjithashtu edhe emrin e tyre tregtar, apo një pjesë të saj, si markë, në këtë rast, duhet të regjistrohen si markë.

Afati i mbrojtjes mund të ndryshojnë, në një pjesë të vendeve market e regjistruara janë mbrojtur për 10 vjet. Regjistrimi mund të rinovohet për një kohë të pacaktuar, me kusht që tarifat e ripërtëritjes të jenë paguar në kohë. Të drejtat ligjore që rrjedhin nga një markë tregtare e regjistruar janë të kufizuara në territorin të cilat ato i përkasin. Gjithashtu marka duhet mbrojtur edhe nga shkeljet që mund të bëhen imazhit te saj, si psh: Gjykata Europiane e Drejtësisë në

çeshtjen *L'Oreal v BELLURE* (5) është shprehur se përbën shkelje të markës si dhe dëmtimin e imazhit të saj (6).

Subjektet e regjistrimit të markës

Në përgjithësi, çdo person i cili ka për qëllim të përdorë një markë tregtare ose të përdoret nga palët e treta mund të aplikojnë për regjistrim. Ajo mund të jetë individ i ose një person juridik.

Regjistrimi nuk është i detyrueshme, por është i këshillueshme, sepse regjistrimi jep të drejtën ekskluzive për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të markës tregtare. Kërkesa për regjistrim mund të refuzohet, arsyet e refuzimit janë si më poshtë:

- Përdorimi i termave të përgjithshëm për një produkt;
- përdorimi i termave përshkrues;
- në rastin e markave tregtare mashtruese;
- Marka konsiderohen të jetë në kundërshtim me rendit publik ose moralit.
- Flamuj, stema shtetërore, shenjat dalluese dhe emblemat e shteteve dhe organizatat ndërkombëtare të cilat kanë qenë të lidhura nga Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s të cilat janë të përjashtuar nga regjistrimi.

Hapat për regjistrimin e një marke.

Aplikuesi: duhet të dërgoj ose të dorëzoj një formular të plotësuar aplikimi për markën tregtare, e cila do të përfshijë detajet e kontaktit të aplikusit/Kompanis, një ilustrim grafik të markës së tij, një përshkrim të e mallrave dhe shërbimeve për të cilat biznesi dëshiron të regjistroj markën dhe të paguajnë taksat e nevojshme.

Zyra për market tregtare: Hapat që ndiqen nga zyra e markës tregtare për të

regjistruar një markë ndryshonë nga vendi në vend, por në përgjithësi ndjekin një model të ngjashëm:

- 1) **Ekzaminimi formal:** zyra për market tregtare e shqyrton atë për t'u siguruar se ajo

është në përputhje me kërkesat administrative.

- 2) **Ekzaminimi substancial:** në disa vende zyra gjithashtu shqyrton kërkesën për të verifikuar nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore.
- 3) **Publikimi dhe kundërshtimi.**
- 4) **Regjistrimi:** pasi ajo nuk ka arsye për refuzim, markë tregtare regjistrohet dhe një certifikatë e regjistrimit lëshohet dhe është e vlefshme për 10 vjet.
- 5) **Rinovimi:** Marka mund të ripërtërihet për kohë të pacaktuar duke paguar taksat e nevojshme për rinovimin, por regjistrimi mund të anulohet tërësisht për mallra ose shërbime të caktuara nëse marka nuk është përdorur për një periudhë të caktuar kohe të përcaktuar në ligjin për market tregtare.

Koha e nevojshme për regjistrimin e një markë tregtare do të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një vend në tjetrin, në përgjithësi duke filluar nga tre muaj në dy vjet, në varësi nga zyra e markës që kryen ekzaminimi thelbësor.

Si mund të regjistrojmë markën tregtare jashtë vendit? Pasi të keni regjistruar markën në vendin ku ajo është e vendosur, ka tre mënyra kryesore për të regjistruar markën tregtare në vendet e tjera:

- **Rruga Kombëtare:** Biznesi mund të aplikojnë në zyrën e markës tregtare të çdo vendi në të cilin ai është duke kërkuar mbrojtje duke parashtruar kërkesa përkatëse në gjuhën e kërkuar dhe duke paguar taksat e nevojshme.
- **Rruga Rajonale:** Nëse do duam të aplikojm për mbrojtje në vendet të cilat janë anëtare të një sistem rajonal të markës tregtare që mund të aplikojm për regjistrim që të ketë efekt edhe në territoret e të gjitha këtyre vendeve anëtare, duhet të dorëzojm një kërkesë në zyrën rajonale kompetente. Zyrat rajonale për market tregtare janë:
 - 1) Zyra Rajonale Afrikane për Pronësinë Industriale;
 - 2) Zyra e Beneluksit për marakt tregtare;
 - 3) Zyra për Harmonizimin e Tregut të brendshëm të Bashkimit Europian;

4) Organizata AFRICAINE *de la Propriété Intellectuelle*.

- **Rruga Ndërkombëtare:** Nëse vendi është anëtar i sistemit të Madridit dhe marka është regjistruar ose zbatohet për në ose me efekt në atë vend, mund të përdoret sistemi i Madridit (i administruar nga WIPO) për të regjistruar markën në më shumë se 70 vendet që janë palë e sistemit. Avantazhi i përdorimit të sistemit të Madridit është se pronari i markës tregtare mund ta regjistroj markën e tij në të gjithë vendet antare në sistemin e Madridit me paraqitjen e:
 - 1) një aplikim të vetëm ndërkombëtar;
 - 2) në një gjuhë;
 - 3) subjekt i një sërë tarifave dhe afateve.

Llojet e markave tregtare janë:

Shenja dalluese	Marka përdoret për të dalluar mallrat e caktuara, si ato të prodhuara nga një ndërmarrje e veçantë.
Markat shërbimit	Marka përdoret për të dalluar disa shërbime si ato të parashikuara nga një ndërmarrje e veçantë.
Markat kolektive	Marka përdoret për të dalluar mallrat ose shërbimet e prodhuara apo të dhëna nga anëtarët e një shoqate.
Markat e çertifikuara	Markat përdoren për të dalluar mallrat ose shërbimet që përputhen me një grup e standardeve dhe janë certifikuar nga autoriteti certifikues.
	Markat që konsiderohen të jenë të njohura në treg

Markat e njohura	dhe gëzojnë mbrojtje të fortë.
------------------	--------------------------------

Regjistrimi i një marke tregtare refuzohet edhe nëse kjo është në konflikt me një markë tregtare ose shenjë tjetër dalluese. Dispozitat përkatëse janë në Neni 8 CTMR dhe 4 TMD.

Sistemi për klasifikimin e markave tregtare.

Në shumicën e vendeve, për të treguar mallrat dhe / ose shërbime për të cilat kërkohet të regjistrohet një markë, kjo do të bëhet sipas klasave ose grupit që i takon një markë tregtare. Sistemi i klasifikimit lejon për ruajtjen e të dhënave për markat e regjistruara në një mënyrë të rregullt në lidhje me llojet e mallrave ose shërbime.

Sistemi më i përdorur i klasifikimit është Klasifikimi Ndërkombëtar i Markave Tregtare, i cili ka 34 klasa për mallrat dhe një 11 klasa për shërbimet. Sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave tregtare siguron një procedurë të vetme për regjistrimin e një marke tregtare në disa territore.

Konventa e Parisit

Neni 6ter i Konventës së Parisit

Neni 6ter i Konventës së Parisit mbron flamujt dhe simbolet e shteteve që janë palë e Konventës së Parisit, si dhe emrat dhe emblemat e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare kundër regjistrimit të paautorizuar dhe përdorim si marka tregtare. Neni 6ter të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale e vitit 1883 (1967 Stokholm Act) u prezantua në Konventën e Parisit nga Konferenca e Hagës në vitin 1925 (7). Ajo ka pësuar disa modifikime të vogla, si për të formuar, në Konferencën e redaktimeve të Londër në vitin 1934, dhe u rishikua më në tërësi nga Konferenca e redaktimeve të Lisbonës në vitin 1958. Qëllimi i nenit 6ter është për të mbrojtur stemën shtetërore, flamurin dhe simbolet tjera të shtetit të Palës Shteteve të Konventës së Parisit, si dhe shenjat zyrtare dhe shenjat dalluese që tregojnë

kontroll dhe garanci të miratuar nga ana e tyre. Kjo mbrojtje u zgjerua për stemën shtetërore, flamujt, stemat tjera, shkurtesat, dhe emrat e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare nga Konferenca e redaktimeve të Lisbonës në vitin 1958.

Procedura e komunikimit.

Çdo emblemë ose shenjat e tjera zyrtare të përmendura më lart për të cilat një shtet palë i Konventës së Parisit ose një organizate ndërqeveritare ndërkombëtare dëshiron që të marrë mbrojtje duhet të komunikoj Byrosë Ndërkombëtare e WIPO, e cila pastaj do të komunikojë atë të palës tjetër të Bashkuara në Konventën e Parisit. Deri në mars 31, 2009, ky komunikim është bërë në formën e një botimi gjysmë-vjetore në një bazë të dhënash elektronike në faqen e internetit e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Megjithatë, një komunikim i tillë nuk është i detyrueshëm në lidhje me flamujt e shteteve.

Fusha e mbrojtjes

Mbrojtja e ofruar nga neni 6ter simboleve apo shenjave të tjera zyrtare të përmendura më lart, nuk është e një natyre të përgjithshme. Qëllimi i nenit 6ter është që të ndalojë regjistrimin dhe përdorimin e markave tregtare të cilat janë identike me apo të paraqesë një ngjashmëri të caktuar me emblemat e lartpërmendura apo shenjat zyrtare.

Neni 6ter është i zbatueshëm vetëm për markat tregtare dhe nuk i detyron shtetet palë të Konventës së Parisit për të refuzojë ose shfuqizimin e regjistrimit, dhe për të ndaluar përdorimin e emblemave shtetërore apo shenja të tjera si një shenjë të shërbimit ose si një element i një marke të shërbimit. Shtetet janë megjithatë të lira për të bërë këtë, dhe në bazë të nenit 16 të Traktatit Ligjor mbi market tregtare (TLT) dhe neni 16 të Traktatit të Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare (8), Shtetet pjesë të këtyre Traktateve janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje të nenit 6ter kundër regjistrimit të përdorim si markat e shërbimit.

Shenjat e mbrojtura: Lista e artikujve të cilat mund të jenë subjekt i një komunikimi bazë të

nenit 6^{ter} të Konventës së Parisit, me kërkesë të një shteti palë të kësaj Konvente përfshin: stemën shtetërore, flamujt dhe simbolet e tjera shtetërore, si dhe shenjat zyrtare dhe shenjat dalluese që tregojnë kontroll dhe garanci të miratuar nga vetë shteti. Shprehja "emblemata të tjera shtetërore" është i paqartë. Ajo është e njohur përgjithësisht duke l'u referuar çdo emblem që përbënë simbolin e sovranitetit të një shteti. Një emblemë e shtetit shpesh përmban elemente heraldikë, të tilla si një luan, një shqiponjë, diell

Qëllimi i shenjave zyrtare dhe shenjat dalluese tregojnë kontroll dhe garanci për të vërtetuar se si një shtet ose një organizatë e emëruar duhet të kontrolloj mallrat e caktuara për të përmbushur standardet specifike ose të ketë një nivel të caktuar të cilësisë. Shenjat zyrtare dhe shenjat dalluese që tregojnë kontroll dhe garanci ekzistojnë në disa shteteve në lidhje me metale të çmuara ose të produkteve të tilla si gjalpë, djathë, mish, pajisjet elektrike, etj... Në parim, shenjat zyrtarë dhe shenjat dalluese që tregojnë kontroll dhe garanci mund të zbatohen edhe për shërbimet, për shembull ato që lidhen me arsimin, turizmin, etj... Mbrojtja si një shenjë zyrtare që tregon kontrollin dhe garanci është më e kufizuar se sa një mbrojtje si një emblemë të Shtetit. Neni 6 (2) siguron që një mbrojtje e tillë "do të aplikohet vetëm në rastet kur shenjat në të cilat ato janë të përfshira janë të destinuara për t'u përdorur në mallrat e njëjtë ose të ngjashme lloj të". Sipas nenit 16 të TLT, kjo dispozitë shtrihet edhe te shërbimet.

Mbrojtja e ofruar nga neni 6 është zgjeruar nga Konferenca e redaktimeve të Lisbonës në vitin 1958, jo vetëm për stemën shtetërore, flamujve dhe emblemave të tjera, por edhe me emra, dhe shkurtesat e emrave të tillë të organizatave ndërqeveritare të cilat një ose më shumë palë të Amerikës në Konventa e Parisit janë anëtarë. Megjithatë, mbrojtja sipas nenit 6 nuk shtrihet në stemën shtetërore, flamujt, stemat tjera, emrat dhe shkurtesave të organizatave ndërqeveritare të cilat janë bërë objekt i marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi.

Traktati i Lisbonës

Cilat janë Avantazhet e Mbrojtjes në kuadër të Sistemit të Lisbonës (9)?

Treguesit gjeografikë mbrohen në përputhje me traktatet ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare nën një gamë të gjerë të koncepteve, duke përfshirë ligjet *sui generis* për mbrojtjen e të dhënave gjeografike apo emërtimet e origjinës, ligjeve të markës tregtare në formën e shenjave kolektive ose shenjat e çertifikimit, ligjet kundër konkurrencës së pandershme, ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, apo ligje të veçanta ose dekretet që njohin shenjat individuale gjeografike. Sigurimi i mbrojtjes për indikacione të tilla në vende të tjera janë të komplikuar për shkak të dallimeve në konceptet ligjore ekzistuese nga vendi në vend në këtë drejtim. Siç tregon emrin e saj, Marrëveshja e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe Regjistrimin Ndërkombëtar i tyre (në tekstin e "Marrëveshjes së Lisbonës") është konstatuar në mënyrë specifike në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategori të veçantë të treguesve të tillë gjeografike, dmth "emërtimeve të origjinës", në vende të tjera se sa në vendin e origjinës, me anë të regjistrimit të tyre me WIPO përmes një procedure të vetme, për një minimum prej formaliteteve dhe shpenzimet. Marrëveshja e Lisbonës ndihmon mbrojtjen e interesave ekonomike kombëtare: në shumë vende, mallrat që mbajnë emërtimin e origjinës përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të eksporteve, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që emërtimet duhet të mbrohen në mënyrë efektive kundër çdo ndarje në numrin më të madh të mundshëm të vendeve.

Çfarë është Emërtimi i origjinës?

Emërtimi i origjinës është një lloj i veçantë i treguesit gjeografik. Ajo në përgjithësi përbëhet nga një emër gjeografik apo emërtimi tradicional i përdorur në produktet të cilat kanë një cilësi të veçantë ose karakteristika që janë në thelb për shkak të mjedisit gjeografik në të cilin ata janë prodhuar. Sipas nenit 2 të Marrëveshjes së Lisbonës, emërtimet e origjinës përcaktohen si më poshtë: "Emërtimi i origjinës do të thotë emërtimi gjeografik i një vendi, rajoni ose

lokaliteti që shërben për të përcaktuar një produkt origjinal aty, cilësinë ose karakteristikat të cilat janë për shkak ekskluzivisht ose në thelb për mjedisin gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrore dhe njerëzore. Vendi i origjinës është vendi, emri i të cilit ose vendi në të cilin është vendosur në rajon apo lokalitet emri i të cilit, përbën emërtimin e origjinës që i ka dhënë një produkti reputacionin e saj. "Më konkretisht, në kuadër të Marrëveshjes së Lisbonës Palët Kontraktuese marrin përsipër të mbrojnë në territoret e tyre këto emërtimet e origjinës së produkteve të nënshkruesit e tjerë të Marrëveshjes të parashikuara kanë qenë të regjistruar në WIPO. Në mënyrë që të kualifikohen për regjistrim ndërkombëtar, mbrojtjen e emërtimit të origjinës duhet të ketë qenë formalizuar më parë në vendin e origjinës, qoftë me anë të dispozitave legislative, dispozitat administrative, një vendim gjyqësor ose ndonjë formë regjistrimi.

Pse mbrohen emërtimet e origjinës?

Emërtimet e origjinës janë një mjet kolektive për prodhuesit për të promovuar produktet e territorin e tyre dhe gjithashtu të ruajnë cilësinë dhe reputacionin e e fituar me kalimin e kohës. Përdorimi i emërtimit të origjinës është i rezervuar për ata prodhuesit që muk janë në gjendje të përmbushin një numër të specifikave, duke përfshirë zonën gjeografike të prodhimit, metodat e prodhimit, specifikat e produktit, etj... (10)

Si i tillë, një sistem efektiv dhe modern për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës është kur:

- Prodhuesit: emërtimi ndihmon prodhuesin të marrë çmime të mira për prodhimet e tij. Në këtë kuptim, emërtimet e origjinës mund të perceptohet si një formë e kompensimit për ruajtjen e niveleve të larta dhe të vazhdueshme të cilësisë.
- Konsumatorët: emërtimet e origjinës të sigurojnë garanci për konsumatorët në lidhje me metodat e prodhimit dhe cilësisë.
- Zhvillimi ekonomik: emërtimet e origjinës janë mjete për zhvillimin dhe promovimin e rajoneve dhe vendeve. Kur emri i një produkti merr mbrojtje si emërtimin e

origjinës, komunitetet lokale të përfitojnë nga ndikimi pozitiv, në mënyra të ndryshme:

- 1) emërtimi rrit prodhimin dhe krijon vende pune (strategji dallim që rezulton në çmime më të larta, gjithashtu duke ndihmuar për të mbështetur prodhimin e produkteve tradicionale)
- 2) emërtimi mundëson duke përmirësuar rishpërndarjen e vlerës së shtuar në të gjithë zinxhirin prodhimi, nga prodhuesi i lëndës së parë.

Direktiva mbi markat tregtare në Bashkimin Evropian.

Direktiva mbi markat tregtare në fazën e parë ishte për të harmonizuar ligjet kombëtare, nëpërmjet Direktivës së vitit 1988 (TMD) (11). Përsa i përket njohjes tregtisë kombëtare të markave, ligjet nuk sigurojnë mbrojtje të njëjtë, kjo mund të pengojnë lëvizjen e lirë të mallrat dhe sjellë prishje të konkurrencën brenda tregut të vetëm, Direktiva (12) nuk ka bërë përpjekje për harmonizim në shkallë të plotë të ligjeve të shteteve anëtare, por lë shtetet anëtare të lira të përcaktojnë dispozitat procedurale lidhur me regjistrimin, revokimin dhe pavlefshmërinë e markave tregtare

Masat e Komunitetit Evropian: Komuniteti trajton falsifikimin dhe piraterinë duke marrë parasysh ato si një kërcënim real për funksionimin e duhur të Tregut të Vetëm. Ato kanë potencial që të ndikojnë negativisht në tregti dhe investimet, dhe të shtrembërojë konkurrencën. Pasojat e tyre mund të ndihet jo vetëm në sferën ekonomike, por edhe në sferat e mbrojtjes së konsumatorit, shëndetit publik dhe sigurisë. Komisioni filloi konsultimin në tetor të vitit 1998 me anë të Kartës së Gjelbër, *Lufta kundër falsifikimit dhe piraterisë në Tregun e Vetëm*. Komisioni vazhdon të shprehë shqetësimin serioz rreth falsifikimit. Teknikat moderne, të sofistikuara dhe të gatshme në dispozicion lejojnë piratët për prodhimin e produkteve të falsifikuara.

Literatura

(1) Making a Mark: An Introduction to Trademarks for Small and Medium-sized Enterprises. WIPO publication No. 900, pg. 3,4,6.

(2) First Council Directive of 21 December 1988 to approximate the laws of the Member States relating to trade marks (89/ 104 /EEC), 11. 2. 89 Official Journal of the European Communities No L 40 / 1.

(3) Regulation (EU) 2017/1001 of the European Parliament and of the Council of 14 June 2017 on the European Union trade mark, 16.6.2017, Official Journal of the European Union L 154/1.

(4) Case 102/77. Hoffmann-La Roche & Co. AG v Centrafarm Vertriebsgesellschaft Pharmazeutischer Erzeugnisse mbH. Judgment of the Court of 23 May 1978.

(5) Case C-487/07. L'Oréal SA, Lancôme parfums et beauté & Cie SNC and Laboratoire Garnier & Cie v Bellure NV, Malaika Investments Ltd and Starion International Ltd. Judgment of the Court (First Chamber) of 18 June 2009.

(6) Tanya Aplin, Jennifer Davis, Intellectual Property Law: Text, Cases and Materials, Oxford University Press, 2013, pg. 377.

(7) Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale e vitit 1883.

Dreier TH., Kur A., European Intellectual Property Law, Edward Elgar Cheltenham, UK• Northampton, MA, USA, 2013

(8) Singapore Treaty on the Law of Trademarks.

(9) Traktati i Lisbonës

(10) MacQueen, Hector L; Charlotte Waelde and Graeme T Laurie (2007). Contemporary Intellectual Property: Law and Policy. Oxford University Press. ISBN 978-0-19-926339-4.

(11) Seville C., EU Intellectual Property Law and Policy, MPG Books Ltd, Bodmin, Cornwall, 2009, pg.7, ISBN 978 1 84720 1232

(12) Kur A., Dreier Th., European intellectual property law: Text, cases and materials, Edward Elgar Publishing, 2013, pg.159-160.

Buxheti dhe borxhi publik me vështrim në Republikën e Kosovës

Prof. ass.dr. Agim Berisha

Kolegji Biznesi, Fakulteti Ekonomik, agim.berisha74@hotmail.com

Abstract

The paper addresses issues related to the budget and public debt in the Republic of Kosovo. The importance of the paper consists in addressing issues related to the budget and public debt in the Republic of Kosovo. The main purpose of this paper is to analyze the performance of budget revenues and expenditures and public debt in recent years in the Republic of Kosovo. In order to achieve the objectives, the method of analysis is used mainly, tabular and graphic separately, comparative method, analyzing in dynamics the issue related to the state budget and public debt in the Republic of Kosovo. Through this study, the results and recommendations given are considered to be considered by policy makers in the Republic of Kosovo.

Keywords: *Budget, public revenues, public expenditures, public debt.*

Përmbledhje

Punimi trajton çështje lidhur me buxhetin dhe borxhin publik në Republikën e Kosovës. Rëndësia e punimit konsiston në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin dhe borxhin publik në Republikën e Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij punimi konsiston në analizën e ecurisë së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe borxhit publik viteve të fundit në Republikën e Kosovës. Për arritjen e objektivave përdoren kryesisht metoda e analizës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, duke analizuar në dinamikë çështjen që lidhen me buxhetin e shtetit dhe borxhin publik në Republikën e Kosovës. Përmes këtij studimi rezultatet dhe rekomandimet e dhëna konsiderojmë të merren në konsideratë nga politikëbërësit në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: *Buxheti, të hyrat publike, shpenzimet publike, borxhi publik.*

Hyrje

Në Republikën e Kosovës, financat publike aktualisht funksionojnë bazuar në Kushtetutë dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe akte tjera ligjore. Shteti si njësi ekonomike siguron flukse hyrëse monetare nëpërmjet instrumenteve të tatimeve, taksave apo fitimeve të ndërmarrjeve ekonomike ku ai është pronar dhe i shpenzojnë ato si flukse dalëse për të realizuar objektivat e që janë në dobi të shoqërisë në tërësi dhe individit në veçanti. Në kuadër të politikave qeveritare, çështje mjaftë e rëndësishme konsiderohet padyshim buxheti në kuadër të kësaj edhe borxhi publik. Në këtë punim objektivat kryesore konsistojnë në:

- Analizën e ecurisë së të hyrave dhe shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës viteve të fundit.
- Të analizojë ecurinë e borxhit publik në Republikën e Kosovës viteve të fundit.

Metodologjia e përdorur

Për finalizimin e këtij punimi, materiali i paraqitur ka mbështetje si vijon:

- a) Literaturë vendëse dhe të huaj, si dhe raporte e publikime nga Ministria e Financave, ku trajtohen çështje të buxhetit të shtetit dhe borxhit publik në Republikën e Kosovës.
- b) Është përdorur burimi statistikor vendas,

metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

Rishikimi i literaturës

Zhvillimet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës

Sistemi buxhetor është pjesë e sistemit financiar, të cilat kanë lidhshmëri të ngushtë mes veti. Krahas zhvillimit të sistemit të financave publike është zhvilluar edhe sistemi buxhetor. Menjëherë pas luftës, filloi të ndërtohet sistemi buxhetor i Kosovës, nën administrimin e Shtyllës IV të UNMIK-ut dhe asistencës teknike dhe financiare të Bankës Botërore. Që nga shtatori i vitit 1999 filloi të vendoset sistemi tatimor dhe të vilen të ardhura buxhetore. Me Rregulloren Nr.1999/3, më 31.Gusht.1999 vendosen tarifa doganore me normë prej 10%, akciza dhe tatimi në shitje me normë prej 15%, të cilat shënojnë fillimin e sistemit tatimor dhe krijimin e parakushteve për vjeljen e të ardhurave buxhetore duke paraqitur një nga parakushtet për funksionimin e Sistemit Buxhetor të Kosovës. Me qëllim të ndërtimit të institucioneve financiare, menjëherë pas luftës u themelua Autoriteti Qendror Fiskal (AQF), i cili veproi nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së në Kosovë.

Menjëher pas përfundimit të luftës së vitit 1999, përveç AQF-së si institucione financiare të rëndësishme në fushën e financave publike, përkatësisht për funksionalizimin dhe financimin publik përmes buxhetit të shtetit ishte themelimi i Doganave të Kosovës (Shërbimi Doganor) me Rregullorën e UNMIK-ut, Nr.1999/3, Për themelimin e Doganës dhe të shërbimeve të tjera përkatëse në Kosovë, me datë: 31.Gusht.1999 dhe themelimi me Rregulloren 2000/20 i Administratës Tatimore të Kosovës, e cila është ndër institucionet e para në kuadër të strukturës së përbashkët administrative, ku stafi vendor merr kompetenca të plota për zbatimin e politikës dhe menaxhimin e procedurave tatimore. Në kuadër të kompetencave të institucioneve shtetërore, sa i përket përgjegjësisë për koordinimin dhe menaxhimin e financave publike, përkatësisht të Buxhetit të Kosovës kompetente është Ministria e Financave. Fillimisht, lidhur me zhvillimin e financave publike në Kosovë, ndër vite është bërë bartja e kompetencave, përkatësisht përgjegjësit janë bartur prej ndërkombëtarëve (AQF-ja) te vendorët (MEF-

i). Në kuadër të transferimit të kompetencave është themeluar Këshilli Ekonomik dhe Fiskal, i cili ka marrë kompetencat rreth menaxhimit të financave publike e që janë bartur në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave e që është një hap i rëndësishëm në zhvillimin, menaxhimin dhe funksionimin e financave publike në Kosovë.

Sa i përket funksionimit ligjor të financave publike dhe të sistemit buxhetor, në fillim është mbështetur në Rregulloren Nr. 2000/17, ndërsa në Maj 2003, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 2003/2, Për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ndërsa, në zhvillimin e mëtejshëm të financave publike, vlen të theksohet se pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi, Ligjin Nr. 03/L-048, Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Në Republikën e Kosovës, financat publike aktualisht funksionojnë bazuar në Kushtetutë dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe akte tjera ligjore. Neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kapitullin mbi financat publike, përshkruan këto kompetenca:

- 1) Shpenzimet publike dhe mbledhja e të ardhurave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.
- 2) Administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisë do të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës.
- 3) Huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Përveç tjerash, neni 65 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndër të tjera Kuvendit të Kosovës i jep kompetenca për miratimin e buxhetit të shtetit.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

Shteti si njësi ekonomike siguron flukse hyrëse monetare nëpërmjet instrumenteve të tatimeve, taksave apo fitimeve të ndërmarrjeve ekonomike ku ai është pronar dhe i shpenzojnë ato si flukse dalëse për të realizuar misionet e tij në dobi të shoqërisë në tërësi dhe individit në veqanti.(1) Burimet nëpërmjet të cilave, qeveria siguron paratë për ofrimin e të mirave publike, quhen të hyra publike.

Të hyrat konsistojnë kryesisht në të hyra nga tatimet dhe taksat, si dhe fitimet e kompanive shtetërore.(2) Mund të themi se kryesisht të ardhurat e qeverisë sigurohen nga taksat dhe tatimet mbi aktivitetet e individëve apo të bizneseve private. Në shtetet moderne pjesa kryesore e të hyrave publike përbëhet nga ato tatimore. Në këtë kuadër, në shtetet bashkëkohore pavarësisht në shtetet e zhvilluara apo shtetet në zhvillim lidhur me tatimet duhet theksuar se; tatimet janë burimi kryesor dhe më i rëndësishëm i mbledhjes së të hyrave publike të cilat shërbejnë për plotësimin e shpenzimeve publike brenda vitit fiskal. Nga ky këndvështrim, duke qenë se tatimet paraqesin një prej burimeve kryesore të të hyrave të përgjithshme buxhetore, padyshim se tatimet janë të hyra të domosdoshme dhe të përhershme të shtetit. Të hyrat buxhetore në Kosovë përbëhen


kryesisht nga të hyrat tatimore, duke përfshirë të hyrat nga tatimet indirekte dhe të hyrat nga tatimet direkte. Në kuadër të tatimeve indirekte përfshihen: TVSh-ja e brendshme dhe TVSh-ja në importe, akciza dhe dogana, ndërsa në kuadër të tatimeve direkte përfshihen: Tatimi në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat personale. Përveç kësaj të hyrat buxhetore përfshijnë të hyrat e mbledhura në kufi (të hyrat kufitare) dhe të hyrat e mbledhura brenda vendit (të hyrat e brendshme). Burimi kryesor në kuadër të të ardhurave tatimore për të hyrat buxhetore e zë Tatimi mbi Vlerën e shtuar (TVSh-ja). Në Republikën e Kosovës grumbullimi i mjeteve buxhetore realizohet nga dy institucionet të cilat janë të autorizuara të bëjnë administrimin mjeteve, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Tabela 1: Struktura e të hyrave buxhetore

-në milionë euro					
Përshkrimi	2019	2020	2021 Proj.	2022 Proj.	2023 Proj.
Gjithsej të hyrat buxhetore	1,888.2	1,788.5	1,887.9	2,002.0	2,097.8
Të hyrat tatimore	1,662.0	1,565.2	1,677.6	1,766.5	1,849.7
Tatimet direkte	292.3	282.4	304.0	318.8	337.3
Tatimi në të ardhurat e korporatave	94.6	89.8	98.0	99.6	105.2
Tatimi në të ardhurat personale	165.6	159.6	171.4	174.3	184.0
Tatimi në pronë	27.3	28.7	30.0	40.1	42.9
të tjera	4.8	4.4	4.6	4.9	5.1
Tatimet indirekte	1,415.3	1,322.4	1,419.2	1,496.1	1,563.1
Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh)	845.6	790.5	862.2	913.1	954.5
Detyrimi doganor	130.3	105.9	128.2	138.1	144.8
Akcizat	435.5	422.6	425.3	441.2	459.8
të tjera	3.8	3.4	3.5	3.7	3.9
Rimbursimet tatimore	-45.5	-39.6	-45.5	-48.4	-50.7
Të hyrat jo-tatimore	214.6	188.9	199.8	225.0	237.6
Taksa, ngarkesa dhe të tjera- Niveli Qendror	121.4	105.0	114.1	121.2	127.9
Taksa, ngarkesa dhe të tjera- Niveli Lokal	50.0	47.1	48.0	50.6	53.4
Taksa Konkensionare	11.1	2.7	19.0	20.1	23.1
Renta Minerare	29.4	30.2	15.7	30.2	30.2
Të hyrat nga interesi (NP-ve)	2.7	4.0	3.0	3.0	3.0
Grante për mbështetja buxhetore	11.5	34.4	10.5	10.5	10.5
Grantet e përcaktuara të donatorëve	8.0	12.0	12.0	12.0	12.0

Burimi: Ligji Nr. 07/L-041, Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, fq, 19.

Grafiku 1: Struktura e të hyrave buxhetore



Nga tabela dhe përmes grafikut shihet se, të hyrat buxhetore kanë pasur një trend rritës nga një periudhë në tjetrën. Në strukturën e të hyrave buxhetore dominojnë të hyrat nga tatimet indirekte në krahasim me të hyrat nga tatimet direkte, d.m.th se të hyrat buxhetore vazhdojnë të varen nga arkëtimi i të hyrave kufitare.

Tatimet mbesin burimi kryesor i të hyrave buxhetore të shteteve bashkëkohore. Vend qendrorë në sistemin e të hyrave shtetërore në vendet në zhvillim kanë tatimet, madje tatimet indirekte.(3) Një nga arsyet që tatimet indirekte, në vendet në zhvillim janë forma kryesore e të hyrave buxhetore mbetet se procedura e caktimit, pagimit dhe e kontrollit të pagimit të këtyre tatimeve është më e thjeshtë. Vendet transitorë me nivel të ulët zhvillimor në strukturën e të hyrave buxhetore kryesisht varen nga të hyrat kufitare. Një situatë e tillë e ka përcjellë edhe Kosovën që nga periudha e pasluftës, ku vërehet pjesëmarrja më e madhe e të hyrave kufitare në mbushjen e buxhetit të shtetit, kundrejt të hyrave të brendshme.(4) Të hyrat e brendshme janë tatimet të cilat mblidhen nga tatimpaguesit brenda territorit të Kosovës.(5) Në

strukturën e të hyrave buxhetore, pjesëmarrja e mbledhjes së të hyrave të brendshme edhe përkundër trendëve pozitive, akoma është e ulët në krahasim me të hyrat kufitare.

Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet publike paraqesin shpenzimin e mjeteve financiare për plotësimin e nevojave publike të cilat janë krijuar me mbledhjen e të hyrave publike. Shpenzimet publike janë të lidhura ngushtë me të hyrat publike dhe varen nga to, pasi pikërisht të hyrat publike janë burim i financimit të shërbimeve publike. Shpenzimet që kryen shteti për përmbushjen e objektivave dhe funksioneve të tij, njihen edhe si të dala publike. (6)

Në kuadër të politikave qeveritare, çështje mjaftë e rëndësishme konsiderohet çështja e shpenzimeve qeveritare. Për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale duhet kushtuar vëmendje, sa shpenzimet e ngarkojnë buxhetin dhe ku orientohet shpenzimi i tyre. Në këtë aspekt veçmas mbetet e rëndësishme mënyra e shpenzimit të mjeteve buxhetore dhe orientimi i shpenzimeve qeveritare për qëllime produktive.


Tabela 2: Struktura e shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës

Përshkrimi	-në 000 euro				
	2019	2020	2021 Proj.	2022 Proj.	2023 Proj.
1.Shpenzimet buxhetore	2,093.4	2,620.4	2,454.2	2,377.3	2,434.7
1.1.Shpenzimet rrjedhëse	1,538.8	1,860.5	1,789.6	1,647.6	1,655.2
Pagat dhe mëditjet	615.9	620.7	625.8	641.8	645.0
Mallrat dhe shërbimet	295.6	315.4	313.9	346.3	346.7

Subvencionet dhe transferet	627.3	678.6	639.1	653.7	658.6
Rezerva rrjedhëse	0.00	34.4	32.8	5.8	4.8
Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike	0.00	364.6	222.4	0.00	0.00
1.2.Shpenzimet kapitale	531.2	729.9	626.1	680.4	718.5
Financimi nga buxheti i rregullt	386.8	397.4	403.1	491.7	529.3
Klauzola e investimeve	12.5	147.5	195.0	188.8	189.2
Fondet e likuidimit (AKP)	131.9	185.0	28.0	0.00	0.00
1.3 Interesi për Borxhin Publik	23.5	30.0	38.5	49.2	61.0

Burimi: Ligji Nr. 07/L-041, Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, fq. 19.

Grafiku 2: Struktura e shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës



Shpenzimet e përgjithshme publike në vitin 2020 nga 2.6 miliardë euro janë realizuar në vlerë prej 2.3 miliardë euro, nga të cilat në kategorinë e pagave dhe shtesave 661.3 milionë euro, mallra dhe shërbime 302.1 milionë euro, subvencione dhe transfere 868.4 milionë euro, ndërsa shpenzime kapitale 384.4 milionë euro. Në buxhetin e vitit 2021 janë planifikuar shpenzimet e përgjithshme publike prej 2.45 miliardë euro, nga të cilat shpenzime rrjedhëse 1.78 miliardë euro, subvencionet dhe transferet 639.1 milionë euro dhe shpenzime kapitale 626.1 milionë euro. Po ashtu, nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike janë planifikuar 222.4 milionë euro, veçmas përmes programit të rimëkëmbjes ekonomike duhet orientuar mbështetjen kryesisht në sektorin privat.

Borxhi publik në Republikën e Kosovës

Kur të ardhurat e buxhetit të shtetit janë më të mëdha se shpenzimet, atëherë diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve quhet suficit i buxhetit të shtetit. Në rastet kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat, diferenca përbën deficitin e buxhetit të shtetit. (7) Në këtë kuadër, ka teori që

sot argumentojnë se në rrethana të caktuara dhe brenda kufijëve të arsyeshëm deficitin buxhetor mund të konsiderohet si një mënyrë e mirë për të luftuar rënien ekonomike. Deficitin rritet në një recesion dhe bie në një bum, madje pa asnjë ndryshim në politikën fiskale.(8)

Kur një qeveri nuk arrin të balancojë buxhetin e saj, asaj i duhet të marrë para hua duke emetuar obligacione në mënyrë që të kompenzojë mungesën.(9) Deficitin e buxhetit të qeverisë është i barabartë me shpenzimet qeveritare minus të ardhurat e qeverisë, e cila nga ana tjetër është e barabartë me sasinë e borxhit të ri që duhet të lëshojë qeveria për të financuar operacionet e saj.(10) Për të mbuluar deficitin buxhetor, qeveritë janë të detyruara të marrin hua. Qeveria për të financuar deficitin buxhetor mund të marrë hua brenda vendit dhe jashtë vendit. Me fjalë tjera borxhi kombëtar përbëhet nga deficitet e akumuluar minus suficitet gjatë gjithë historisë së vendit.(11) Qeveria përmes Ministrisë së Financave, përveç legjislacionit bazë mbi borxhin publik ka hartuar Rregulla dhe Procedura përkatëse, për të

rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktimin e përgjegjësive menaxhuese.

Në shtetet bashkëkohore, përveç tatimeve, taksave, doganave, kontributeve, si burim për financimin e funksioneve të tij, shfrytëzohet edhe borxhi publik. Për të mbuluar deficitin buxhetor, shteti duhet të hyjë borxh, që shprehet negativisht në rrjedhat ekonomike. Këto dy koncepte, deficitit dhe borxhi janë të lidhura ngushtë për shkak se qeveria akumulon borxhin duke reduktuar deficitin ose zvogëluar borxhin e saj duke tejkuluar të ardhurat. Marrëdhënia ndërmjet borxhit dhe deficitit ose suficitit mund të shpjegohet me një analogji të thjeshtë. ***Ndërsa ju futni ujë në një vaskë ("të drejtuar një deficit"), vëllimi i grumbulluar i ujit në vaskë ("borxhi") rritet. Përndryshe, nëse e lëshoni ujin nga vaska ("të drejtuar një suficit"), niveli i ujit ("borxhi") bie.*** Analogjikisht, deficitet buxhetore ngritin borxhin kombëtar, ndërsa suficitit buxhetor e ulin atë.(12) Kur qeveria ka një deficit buxhetor, borxhi i saj rritet, dhe kur ka një tepriçë buxhetore, borxhi i saj zvogëlohet.(13) Nëse një qeveri shet asetet shtetërore, ajo mund të zvogëlojë borxhin e saj edhe pse të ardhurat tatimore janë më të ulët sesa shpenzimet e saj. Borxhi shtetëror në veçanti është i pranishëm në vendet jo mjaft të zhvilluara, i cili ngarkon, edhe ashtu të ballafaquara me probleme të shumta, ekonominë dhe popullatën e këtyre vendeve. Borxhi qeveritar përfaqëson një barrë për ekonominë dhe popullsinë e vendit që e ka këtë borxh.(14)

Aktualisht borxhi shtetëror paraqet një dukuri të përgjithshme, jo vetëm në kuadër të ekonomisë të një vendi, por edhe në përmasa ndërkombëtare. Marrë globalisht, në kuadër të një vendi dallojmë:(15)

- a) Borxhin e brendshëm dhe
- b) Borxhin e jashtëm.

Borxhi i brendshëm është borxhi që një vend i detyrohet qytetarëve të vet.(16) Hyrja borxh e shtetit te qytetarët dhe te subjektet ekonomike të tij zakonisht bëhet me ngritjen e infrastrukturës ekonomike (ndërtimi i rrugës, energjetikës etj.) ose shoqërore (ngritja e objekteve shkollore, spitaleve etj.), e cila kërkon investime të mëdha, ku shteti nuk mund t'i mbulojë nëpërmjet politikës fiskale, përkatësisht mjeteve buxhetore, por shpall hua

publike, për të cilat lëshon obligacione, që me interes të caktuar ua kthen huadhënësve (qytetarëve, subjekteve ekonomike etj.), në kohë dhe me normë të caktuar të kamatës.

Borxhi i jashtëm paraqet borxhin që një vend u detyrohet vendeve të huaja ose institucioneve financiare ndërkombëtare nga të cilat ka marrë hua. Burimet e financimit në të cilat ka qasje Qeveria e Republikës së Kosovës janë burimet e brendshme-borxhi i brendshëm, dhe burimet e jashtme-borxhi ndërkombëtar. Borxhi Shtetëror mund të jetë borxh i drejtpërdrejtë, apo borxh i nën-huazuar. Sa i përket borxhit të nën-huazuar, sipas Ligjit Nr. 03/L-175, Për Borxhet Publike, Ministria ka të drejtë t'i jep hua çdo entiteti në sektorin publik, duke përfshirë Komunitat, nga të hyrat e Borxhit Shtetëror. Kurse sa i përket juridiksionit të cilit i nënshtrohet, Borxhi i Përgjithshëm mund të ndahet në Borxh Ndërkombëtar, dhe në Borxh të Brendshëm, ku Borxhi i Brendshëm i nënshtrohet juridiksionit vendor, ndërsa ai Ndërkombëtar mund t'u nënshtrohet edhe juridiksioneve jashtë Republikës së Kosovës.(17) Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.(18) Me Ligjin për borxhet publike në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-175, janë rregulluar aspekte të ndryshme në lidhje me borxhin publik. Bazuar në ligjin për borgjet publike në Republikën e Kosovës, Ministri i Financave e ka të drejtën për menaxhimin dhe administrimin e borxheve, për të garantuar huat e marra dhe për të zhvilluar programin dhe strategjinë për menaxhimin e borxheve.

Borxhi shtetëror mund të emetohet në formë të letrave me vlerë të qeverisë, ose edhe të kontratave për financim, të cilat i negocion Ministri i Financave si person i vetëm i autorizuar. Sa i përket borxhit shtetëror të Kosovës duhet theksuar se, borxhi shtetëror i Kosovës përfshinë Borxhin Ndërkombëtar, Borxhin e Brendshëm si dhe Garancionet Shtetërore. Me fjalë tjera, lidhur me ecurinë e borxhit shtetëror të Kosovës, fillimisht nga viti 2009 deri në vitin 2012 portofolio e borxhit të Kosovës përbëhej vetëm nga kreditë ndërkombëtare, mirëpo nga viti 2012, Kosova filloi emetimin e letrave me vlerë pjesë e borxhit të brendshëm në kuadër të Borxhit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Me adoptimin e rregullës fiskale, Qeveria synon të ruaj nivel të moderuar të

borxhit publik duke e mbajtur rritjen e tij në normë që qon drejt nivelit të stabilizuar të borxhit e që është nën nivelin e lejuar me ligj. Me fjalë tjera, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-175, Për Borxhin Publik, i aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 29 Dhjetor 2009, Qeverisë i mundësohet për të marrë hua, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e borxheve të saja shtetërore.

Veç kësaj, i jep Ministrit të Financave të drejtën dhe përgjegjësinë, për t'u kujdesur për tërë menaxhimin dhe administrimin e Borxheve. Me Ligjin Nr.03/L-175, Për Borxhin Publik, neni 3, qëllimet e autorizuar për huamarrje, Ministria është entiteti i vetëm i autorizuar për të hyrë në (shkaktuar) borxhe shtetërore për qëllimet në vijim: (19)

1. Për financimin e deficitit të buxhetit shtetëror, kur shpenzimet e autorizuar me ligj tejkalojnë, apo ka mundësi të tejkalojnë, sipas gjykimit (vlerësimit) të Ministrit, të hyrat e nevojshme për t'i paguar ato;
2. Për financimin e projekteve investuese të cilat vlerësohet të jenë synim kombëtar dhe janë të përfshira në BKK (Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës) dhe në KASH (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve);
3. Për të ri-financuar Borxhet Shtetëror të kontraktuar më herët;
4. Për të paguar Garancitë Shtetërore, në tërësi apo pjesërisht, në rastë se

huamarrësit dështojnë ti përmbushin obligimet e tyre të huas;

5. Për të paguar shpenzimin e shërbimit të Borxhit Shtetëror, duke përfshirë, mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në, shpenzimet e ndërlidhura, si për shembull provizione për emetimin e letrave me vlerë, mirëmbajtja e llogarive, riblerjendhe provizionet e agjencive fiskale;
6. Për të paguar shpenzimet e ndërlidhura me një emergjencë kombëtare të shpallur nga Kuvendi.

Qeveria përmes Ministrisë së Financave, përveç legjislacionit bazë mbi borxhin publik ka hartuar Rregulla dhe Procedura përkatëse, për të rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktimin e përgjegjësive menaxhuese. Ligji Nr. 03/L-175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës, neni 1 i këtij ligji jep të drejtën Qeverisë së Republikës së Kosovës për të huazuar para, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore. Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet me Ligjin për Borxhin publik si, tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal. Borxhi i përgjithshëm i Kosovës është borxh shtetëror, pasi Republika e Kosovës akoma nuk ka borxh komunal. Në tabelën në vijim jepet borxhi i përgjithshëm sipas llojit.

Tabela 3: Borxhi i përgjithshëm në Republikën e Kosovës, në periudhën 2009 – 2020


- në milionë euro

Kategoria	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Borxhi Ndërkombëtar	249.0 1	260.0 8	253.7 1	336.6 0	323.7 6	326.3 5	371.17	373.77	422.15	416.43	409.10	525.80
Niveli Qendror	249.0 1	260.0 8	253.7 1	336.4 6	324.3 2	316.5 4	339.87	323.93	365.18	364.53	359.45	479.50
Nën-huazimet	0.00	0.00	0.00	0.14	2.03	9.81	31.30	49.83	56.97	51.90	49.65	46.29
Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Borxhi i Brendshëm	0.00	0.00	0.00	73.31	152.5 1	256.5 2	377.78	478.97	574.27	676.62	791.94	961.90


Komunat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i përgjithshëm	249.01	260.08	253.71	409.92	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42	1,093.05	1,201.05	1,487.69
Garancionet Shtetërore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	10.00	10.00	20.00	44.00	44.00	42.68	31.65
Borxhi përgjithshëm (% BPV)	6.12	5.91	5.27	8.10	8.94	10.65	13.05	14.58	16.63	17.12	17.51	21.83

Burimi: Ministria e Financave, Buletini Vjetor 2017, Mbi Borxhin Publik, fq. 8. Ministria e Financave, Buletini vjetor 2018, Mbi Borxhin Publik, fq. 7. Ministria e Financave, Buletini vjetor 2019, Mbi Borxhin Publik, fq. 7. Ministria e Financave, Të dhënat Tremujore Mbi Borxhin e Përgjithshëm, Tremujori i katërt 2020, Prishtinë, 2021, fq. 5.

Grafiku 3: Borxhi i përgjithshëm në Republikën e Kosovës, në periudhën 2009 – 2020.



Grafik 4: Borxhi i përgjithshëm në raport me BPV-në në Republikën e Kosovës, në periudhën 2009-2020



Nga tabela dhe grafiku vërehet se, borxhi publik i Republikës së Kosovës përfshinë përveç borxhit të jashtëm edhe borxhin e brendshëm. Borxhi publik

në Kosovë në periudhën 2009-2020 ka pasur ecure në rritje, duke u rritur nga 249.01 milionë euro sa ishte në vitin 2009, në 1.4 miliardë euro në vitin 2020. Sa i përket borxhit publik në Republikën e

Kosovës, vërehet ecuria në rritje ndër vite, që kryesisht rritja rrjedh nga emetimet e reja të Letrave me Vlerë që i përkasin borxhit të brendshëm. Në fund të vitit 2020, Borxhi i Përgjithshëm ka arritur vlerën 1.4 miliardë Euro, krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej rreth 23.8%. Në vitin 2020, në kuadër të borxhit të përgjithshëm, borxhi i brendshëm arriti vlerën prej 961.90 euro, ndërsa borxhi ndërkombëtar në vlerë prej 525.80 euro. Po ashtu, borxhi publik në Republikën e Kosovës ka ecuri në rritje sa i përket pjesëmarrjes në BPV-në, duke u rritur pjesëmarrja e borxhit publik në raport me BPV-në nga 6.12% sa ishte në vitin 2009, duke arritur kjo pjesëmarrja në vitin 2020 në 21.83%. Lidhur me këtë, gjatë dy viteve të fundit treguesi Borxh/BPV ka pasur rritje të lehtë, në fund të vitit 2019 ishte 17.51% ndërsa në fund të vitit 2020 duke arritur në 21.83%.

Borxhi i brendshëm paraqet pjesë të borxhit publik që shteti u detyrohet subjekteve ekonomike dhe qytetarëve të vet.(20) Në nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-175 „Për borxhet publike” në Republikën e Kosovës, përcaktohet forma e borxheve, ku një nga format e borxheve është edhe emetimi i letrave me vlerë. Qeveria ka filluar të emetoj Letra me Vlerë (Bona të thesarit) në janar të vitit 2012. Ankandi i parë ishte organizuar dhe ka përfunduar me sukses më 17 janar 2012.(21) Sipas Ligjit për Borxhet Publike(22), Komuna nuk mund të hyjë në borxh publik pa i plotësuar parakushtet e parapara, kështu që aktualisht nuk ka ndonjë borxh komunal.

Borxhi i jashtëm paraqet borxhin që një vend u detyrohet vendeve të huaja ose institucioneve financiare ndërkombëtare nga të cilat ka marrë hua.(23) Borxhi i jashtëm i Kosovës është borxhi që e ngarkon Kosovën ndaj kreditorëve të jashtëm, ku pjesa më e madhe e borxhit është ndaj Bankës Botërore dhe FMN-së. Borxhi Shtetëror i Kosovës është krijuar në vitin 2009. Në atë kohë, portofoli përbëhej prej vetëm një kredie të quajtur Kredia e Konsoliduar C nga Banka Botërore.(24) Shuma totale e kësaj kredie ishte 381.21 milion Euro. Kredia KKC është trashëguar nga ish-Jugosllavia si pjesë e Borxhit Shtetëror të Kosovës. Portofolion e borxhit të jashtëm sipas kreditorëve e përbëjnë Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Agjencia Ndërkombëtare për zhvillim (ANZh), Uni Credit, Agjencia Gjermane për Rindërtim (KfW),

BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), etj.

Konkluzione dhe rekomandime

Buxheti paraqet dokument financiar shtetëror, ku pasqyrohen të hyrat buxhetore sipas burimeve financiare, në një anë, dhe të dalat buxhetore, sipas bartësve dhe destinimit të shpenzimeve, në anën tjetër. Lartësia e shpenzimeve publike është e lidhur ngushtë me të hyrat publike. Kjo do të thotë se shteti i pranon paratë publike për qëllime kolektive dhe për plotësimin e nevojave publike.

Në kuadër të punimit lidhur me buxhetin e shtetit dhe borxhin publik në Republikën e Kosovës paraqesim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet si vijon:

Konkluzione:

Të hyrat publike vazhdojnë të kenë varshërin nga të hyrat në kufi kundrejt nivelin të pjesëmarrjes më të ulët të të hyrave të brendshme.

Shpenzimet publike në Kosovë vazhdojnë të kenë ecuri në rritje, ku në strukturën e shpenzimeve publike rritje më të madhe e kanë shpenzimet rrjedhëse krahasuar me shpenzimet kapitale.

Në kuadër të borxhit publik në Republikën e Kosovës, vlen të theksohet se, Kosova aktualisht ka nivel të ulët të borxhit publik në raport me BPV-në, mirëpo vërehet ecuri në rritje në vitin 2020.

Rekomandime:

- Struktura e shpenzimeve publike duhet të rishikohet duke reduktuar shpenzimet rrjedhëse dhe rritjen e kategorisë së shpenzimeve kapitale, veçmas orientimi në financimin e investimeve publike.
- Programi i rimëkëmbjes ekonomike duhet orientuar kryesisht në mbështetjen e sektorin privat.
- Mjetet e siguruar nga huamarrja e brendshme dhe huamarrja e jashtme përmes borxhit publik duhet orientuar kryesisht në investime publike dhe projekte zhvillimore.

References:

- (1) Drini Salko, *Bazat e Financës*, Tiranë, 2010, fq. 4.
- (2) Gentiana Sharku, Brikena Leka, Entleva Bajrami, *Financa*, Tiranë, 2013, fq. 372.
- (3) Bozhidar Jelçiq, *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*, Prishtinë, 1985, fq. 66.
- (4) Agim Berisha, *Buxheti dhe ecuria e të hyrave buxhetore në Kosovë*, Buletini shkencor Nr.2/Vëllimi 2, 2014, Universiteti „Ismail Qemali“ Vlorë, fq. 31.
- (5) Po aty, fq. 32.
- (6) Gentiana Sharku, Dr.Brikena Leka, Dr.Entleva Bajrami, *Financa*, Tiranë, 2013, fq. 372.
- (7) Drini Salko, *Bazat e financës*, Tiranë, 2010, fq. 276.
- (8) William J. Baumol, Alan S. Blinder William J. Baumol, Alan S. Blinder, *Economics: Principles and Policy*, Eleventh Edition, 2010, fq. 690.
- (9) N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, *Ekonomiksi/Makroekonomia*, Përktheu: Artan Meçi, Jorgji Qirjako, Tiranë, Uet Press, 2012, fq. 557.
- (10) N.Gregory Mankiw, *Macroeconomics*, seventh edition, 2009, fq. 472.
- (11) Drini Salko, *Bazat e financës*, Tiranë, 2010, fq. 276.
- (12) William J. Baumol, Alan S. Blinder William J. Baumol, Alan S. Blinder, *Economics: Principles and Policy*, Eleventh Edition, 2010, fq. 687.
- (13) Parkin Powell Matthews, *Economics*, Sixth edition, fq. 559.
- (14) Mimoza Koka, *Makroekonomia*, Tiranë, 2014, fq. 293.
- (15) Musa Limani, *Makroekonomia*, Prishtinë, 2013, fq. 239.
- (16) Ahmet Mançellari, Dr.Sulo Hadëri, Dr.Dhori Kule, Dr.Stefan Qirici, *Hyrje në Ekonomi*, Tiranë, 2002, fq. 406.
- (17) *Ministria e Financave*, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm, Tremujori i Tretë 2016, Prishtinë, 2016, fq. 4.
- (18) *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 120, Prishtinë, 2008, fq. 48.
- (19) *Kuvendi i Republikës së Kosovës*, Ligji për Borxhin Publik, Nr. 03/L-175, neni 3, Prishtinë, 2009.
- (20) Musa Limani, *Makroekonomia*, Prishtinë, 2013, fq. 237.
- (21) Qeveria e Kosovës, *Ministria e Financave*, *Strategjia vjetore e borxhit 2013*, Prishtinë 2012, fq. 9.
- (22) *Ligjit Nr. 03/L-175, Për borxhet publike në Republikën e Kosovës*, Neni 30, Prishtinë, 2009.
- (23) Musa Limani, *Makroekonomia*, Prishtinë, 2013, fq. 241.
- (24) Qeveria e Kosovës, *Ministria e Financave*, *Buletini vjetor 2015*, Prishtinë, 2016, fq. 8.

Terrorizmi dhe kriminaliteti detar në këndvështrimin juridik të së drejtës ndërkombëtare të detit

Dr. Ermal XHELILAJ¹, Prof. As. Myzafer ELEZI²

¹Departmenti i Shkencave Detare, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

²Kolegji Universitar "Reald"

ABSTRAKT

Industria detare është një prej sektorëve më të rregulluar nga këndvështrimi ligjor në botë, dhe si e tillë kjo industri përballlet me një numër të madh parametrash dhe kriteresh legjislativ. Çdo aspekt i sektorit ndërkombëtar detar është i mbuluar prej rregullash dhe ligjesh të rrepta të natyrës ndërkombëtare, dhe gjatë kalimit të viteve këto standarde ligjore janë zhvilluar duke u kthyer në një koncept gjithëpërfshirës me qëllimin kryesor menaxhimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në këtë sektor. Megjithatë, krijimin i një rrjeti të gjerë e të komplikuar legjislativ nga organizatat ndërkombëtare detare dhe OKB, ambiguiteti e paqartësia që karakterizojnë legjislacionin ndërkombëtar detar lidhur me sigurinë, kriminalitetin dhe terrorizmin detar, si dhe natyra komplekse dhe e vështirë e operimit të anijeve e porteve, kanë sjellë si pasojë disa problematika të natyrës ligjore, të cilat kanë ngritur barriera ligjore e praktike për sa i përket luftës kundër fenomeneve të terrorizmit e kriminalitetit detar.

Fjalë kyçe: E drejta detare, terrorizmi detar, siguria detare, legjislacion detar.

ABSTRACT

Maritime industry is among the most legally regulated industries worldwide. As such, this important maritime sector for the international

economy is facing many challenges related to the massive and complicated international legal framework adopted by international organizations. Every sector of the global maritime industry is well covered by extensive and stringent maritime legal norms which reflect a comprehensive notion with the main purpose of eradicating threats towards maritime industry. Nevertheless, the enactment of these complicated and comprehensive maritime legal norms and conventions, the ambiguity that characterizes UN and IMO legal standards related to maritime security, terrorism and criminality on-board ships as well as harsh and complex nature of working on ships and generally in maritime industry, has brought as a consequence many problems of legal nature which has resulted in created legal issues towards eradicating maritime terrorism and criminality.

Keywords: Maritime law, maritime security, law of the sea, maritime terrorism.

HYRJE

Një prej standardeve më të njohura ligjore në industrinë detare është Kodi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Sigurisë në Anije (International Safety Management Code, ISM Code), një paketë ligjore me natyrë menaxhuese që bashkon të gjitha kërkesat legjislativ të shpëtimit të jetës në det, përfshirë këtu edhe mbështetjen e anijes nga

kapacitetet dhe infrastruktura tokësore, duke siguruar si përfundim edhe aplikimin ose implementimin e këtyre kërkesave në praktikë.

Si rezultat i implementimit të Kodit ISM, industria detare ka evoluar me hapa konstante në mënyrë relativisht të sigurt duke konsoliduar kështu aspektet e shpëtimit të jetës në det dhe menaxhimin e rrezikut dhe sigurisë në anije. Gjithsesi, në këtë kontekst, ka qenë evident fakti që në standardet ndërkombëtare detare ka pasur mangësi esenciale që janë konsideruar nga shumë ekspert detar si një vakum i thellë legjislativ në rang ndërkombëtar (IMO, 2004).

Megjithëse korniza ligjore detare është mjaft e gjerë dhe mbulon pothuajse të gjitha aspektet e industrisë detare si p.sh: shpëtimin e jetës në det, ndërtimin e anijeve, ndotjen detare, trajnimin e detarëve, emigracionin ilegal në anije, punësimin në anije etj., çështjet dhe standardet e rëndësishme të sigurisë dhe kriminalitetit në det nuk kanë ekzistuar asnjëherë, të paktën deri pak vite më parë, si parametra të detyrueshme në rrafshin ndërkombëtar (Jones, 2006).

1. SIGURIA DETARE DHE LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Çështjet e sigurisë dhe kriminalitetit në det dolën në pah në mënyrë tejet problematike vetëm kur ndodhi akti terrorist kundër Qendrës Tregtare Botërore në New York, më 11 shtator 2001. Si rezultat i këtij incidenti ndërkombëtar, shqetësimi se industria detare (anijet dhe portet) mund të ishte një shënjestër e terroristeve, dhe se në këtë sektor të rëndësishëm duhet të prezantoheshin ligje dhe standarde të rrepta ndërkombëtare në mënyrë që të minimizohet impakti terrorist, doli si një domosdoshmëri dhe si një nevojë imediate (Jones, 2006). Ky shqetësim solli si rezultat që Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) të krijonte, duke i dhënë fuqi ligjore më 1 korrik 2004, Kodin Ndërkombëtar mbi Sigurinë e Anijeve dhe Porteve, që kishte si objektiv bazë formulimin e konceptit të menaxhimit të sigurisë dhe kriminalitetit në sektorin ndërkombëtar detar (ISPS Code, 2002).

Në mënyrë që industrisë detare t'i mundësohen parametra sa më të sigurt në mbarëvajtjen e

punëve të transportit dhe tregtisë detare, duhej fillimisht që të perceptohej sa më mirë koncepti i sigurisë në kontekstin e sektorit detar, si një element me natyrë shumë specifike. Në këtë kuadër, përkufizimi i sigurisë prej ekspertëve detar, botimeve shkencore apo edhe organizatave ndërkombëtare është një aspekt shumë i rëndësishëm për t'u kuptuar (Churchill & Low, 1997). Në kuptimin e gjerë të fjalës, përkufizimi që i bëhet sigurisë nga Oxford English Dictionary është si vijon:

- 1) Gjendja e të qenit ose e të ndjerit i sigurt, ose 2) sigurimi i një shteti ose entiteti nga aktivitetet kriminale si terrorizmi ose spiunazhi.

Duke u bazuar në qëllimin e këtij artikulli duhet që përkufizimi i sigurisë të konceptohet në mënyrë më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Pra, me *siguri detare do të nënkuptojmë gjendjen konkrete e të qenit ose e të ndjerit i sigurt të anijes/kompanisë detare/ekuipezhit të anijes/portit, ose sigurimi i anijes/kompanisë detare/ekuipezhit të anijes/portit nga aktet kërcënuese si terrorizmi, pirateri, dhe aktivitete të tjera kriminale* (Jones, 2006).

Problemi kryesor në lidhje me përkufizimin e sigurisë detare është se statusi i konceptimit të këtij termi është trashëguar në vite në mënyrë të paqartë ose i turbullt, për shkak ndoshta edhe të ngjashmërisë që ka me konceptin e shpëtimit të jetës në det (Boisson, 2000). Në këndvështrimin shqiptar, ndoshta të dy këto çështje apo koncepte mund të krijojnë idenë e ngjashmërisë, duke përfshirë këtu edhe emërtimin "siguri detare" apo "shpëtimi i jetës në det", që në mënyrë sipërfaqësore mund të nënkuptojnë të njëjtin element ose të njëjtët komponent përbërës.

Këtë problem të emërtimit të terminologjisë e kanë pasur edhe shtete të tjera si Spanja apo Franca. Kjo ndodh sepse termi "siguri detare", ashtu si edhe në rastin e Shqipërisë, nënkupton të njëjtin komponent; p.sh: termi `seguridad` në spanjisht, dhe termi `securite` në frëngjisht nënkuptojnë të njëjtin konotacion (Jones, 2006). Gjithsesi, ndryshimi kryesor ndërmjet koncepteve të sipërpërmendura qëndron në faktin që në kontekstin e sigurisë detare duhet të merren në konsideratë akte kriminale të

qëllimshme që kryen nga keqbërës aktiv me paramendim me objektivin final për të shkaktuar sa më shumë humbje jetësh njerëzore, dëme financiare e shkatërrime masive (Boisson, 2000).

Nëqoftëse për çështjen në fjalë do të bëjmë një analogji me natyrë sportive, atëherë mund të themi që koncepti i *shpëtimit të jetës në det* mund të konsiderohet si sporti i alpinizmit, në të cilin në qoftë se alpinisti planifikon, përgatitet, pajiset dhe trajnohet në mënyrë sa më optimale, probabiliteti më i madh është që ai do ta kryej me sukses ngjitjen në majën e malit. Në anën tjetër, *siguria detare* për efekt të këtij artikulli mund të krahasohet me lojën e futbollit, në të cilën sado që ekipi ynë mund të jetë i përgatitur dhe i stërvitur për ndeshjen përsëri rezultati i përfundimit të lojës do të jetë shumë i diskutueshëm sepse përballë kemi një ekip tjetër, i cili në mënyrë aktive do të përpiket që t'iu shkaktojë humbjen në shumë mënyrë. (Giles et al, 2003; Jones, 2006).

Shumë rregulla dhe standarde ndërkombëtare, veçanërisht standardet që kanë si objektivi rregullimin e sektorit të anijeve, diktojnë një shkallë të caktuar kompromisi për shkak të natyrës teknike dhe financiare që industria detare ka (Xhelilaj, 2015). Anijet, duke u bazuar në natyrën e punës që kanë, shpesh operojnë në situata dhe vende të rrezikshme. Për të siguruar një anije në shkallën 100% do të duhet që kapaciteti operacional i kësaj anije të minimizohet ndjeshëm, element ky që bie në kundërshtim me qëllimin dhe objektivin që ka industria e anijeve, pra zhvillimin ekonomik ndërkombëtar me anë të transportit dhe tregtisë detare në nivel global (IMO, 2004). Prandaj, është quajtur e nevojshme që aktorët ndërkombëtar detar, organizatat ligj-formuese dhe industria detare në mënyrë që të vazhdojnë tregtinë detare dhe zhvillimin ekonomik përpiqen gjithmonë të gjejnë një rrugë kompromisi në krijimin e standardeve ligjore detare në rrafshin ndërkombëtar (Mukherjee, 2004).

Për sa i përket krijimit dhe implementimit të Kodit ISPS, jo të gjithë aktorët ndërkombëtar detar e kanë pritur në mënyrë entuziaste prezantimin e këtij instrumenti të rëndësishëm ligjor në industrinë detare. Në këtë kuadër, ka pasur opinione negative nga shumë aktor detar

në nivel ndërkombëtar, duke kritikuar Kodin në fjalë se nenet që përfshin janë pothuajse të pazbatueshme në praktikë dhe se, ky Kod nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk shpreh realitetin e industrisë detare në botë (Jones, 2006). Po ashtu, ka pasur edhe opinione apo komente ekstreme në lidhje me Kodin ISPS, duke shkuar deri aty sa to formulohen mendime ose ide se industrisë detare nuk i kanoset asnjë kërcënim apo rrezik, qoftë ky terrorizëm, rrëmbime të dhunshme apo pirateri (Giles et al, 2003).

2. PROBLEMATIKAT LIGJORE MBI TERRORIZMIN DETAR

Krijimi gjatë viteve të fundit i kornizës ligjore ndërkombëtare në lidhje me sigurinë detare, dhe në veçanti prezantimi i Kodit ISPS, ka ardhur kryesisht si pasojë e kërcënimeve të terrorizmit global (një pjesë e të cilit mund të konsiderohen hipotetike), dhe sidomos nga frika dhe paniku që ka mbërthyer mbarë botën pas disa akteve të njohura terroriste në rrafshin ndërkombëtar (ISPS Code, 2002; SUA Convention, 1988). Gjithsesi, nqs do t'i referohemi terrorizmit, atëherë lind pyetja se çfarë nënkuptojmë me dukurinë terrorizëm dhe çfarë mund të përfaqësojë ky koncept kompleks? Po ashtu, me vend do të ishte edhe pyetja: a është aktualisht industria detare nën kërcënimin potencial të terrorizmit (Jones, 2006)?

Tradicionalisht, në këndvështrimin global, gjithmonë ka ekzistuar shqetësimi në lidhje me konceptimin e një përkufizimi të përbashkët, të qartë, dhe të pranueshëm ndërkombëtarisht të terrorizmit (Xhelilaj, 2008). Në këtë funksion, Kombet e Bashkuara kanë arritur që të formulojnë një definicion të terrorizmit të cilin e emërtojnë si "*çdo veprim.....që ka për qëllim të shkaktojë vdekje ose dëmtime të rënda trupore ndaj civilëve dhe personave të paarmatosur në mënyrë që të frikësojë ose të tremb popullsinë civile, Qeverinë ose organizata ndërkombëtare për të zbatuar ose për të hequr dorë nga një vendim/veprim politik i caktuar*" (Jones, 2006).

Mungesa e bashkëpunimit global në lidhje me përkufizimin e konceptit të terrorizmit ka rezultuar gjithmonë një pengesë serioze për marrjen e masave parandaluese ose penalizuese ndaj kësaj dukurie shqetësuese. Persona të

aktuar ose ekspert të ndryshëm kanë shprehur shpesh teorinë se një person që konsiderohet 'terrorist' nga një shtet, mund të konsiderohet një 'luftëtar i lirisë' për një shtet tjetër (Churchill & Low, 1997). Ndërkohë që komenti i mësipërm mund të konsiderohet një teori e thjeshtë për t'u cituar, ekspertëve detar u duhet që të fillojnë të analizojnë çështjen e terrorizmit kundër anijeve, porteve dhe detareve, dhe për qëllimin e këtij artikulli përkufizimi i terrorizmit sipas qëndrimit zyrtar të Kombeve të Bashkuara mund të jetë më shumë i pranueshëm. Gjithsesi, nëq do ta thjeshtojmë çështjen e përkufizimit të terrorizmit atëherë kjo dukuri mund të definohet edhe si 'një veprim i dhunshëm që konsiderohet i papranueshëm e i dënueshëm nga opinioni botëror' (Jones, 2006).

Një prej leksioneve më të vyera që komuniteti ndërkombëtar ka mësuar nga e shkuara në lidhje me terrorizmin dhe kriminalitetin, është se keqmbësuesit shënjestrojnë gjithmonë objektiva të lehtë për të goditur. Përgjithësisht, duke u bazuar edhe nga sa u përmenden më sipër, si dhe nga natyra specifike që ka industria detare, goditja e objektivave detare (anijet, portet etj.) nuk ka qenë e shumë e lehtë mbështetur në faktin që këto shënjestra kërkojnë planifikim koordinim, pajisje dhe përgatitje më të sofistikuar se objektivat apo infrastruktura tokësore. Prandaj, edhe aktivitetet terroriste kundër objektivave detar kanë qenë më të rralla, dhe duke marrë parasysh këtë fenomen terroristet kanë përzgjedhur objektiva më të lehtë për të goditur (Giles et al, 2003; Jones, 2006).

Duke konsideruar faktin që në vitet e fundit masat e sigurisë në sektorin e aviacionit civil janë rritur ndjeshëm, nuk mund të përjashtojmë teorinë që organizatat terroriste të kenë aktualisht në objektivat e tyre implementimin e akteve terroriste në anijet tregtare, porte, platforma naftëkërkuese etj (Xhelilaj, 2015). Kim Petersen, drejtor i grupit të tregtisë pranë Këshillit Detar të Sigurisë ka tërhequr vëmendjen mbi një numër të madh rastesh të rrezikshme duke venë në dukje se "Terroristët jo vetëm e kanë kuptuar vulnerabilitetin e porteve dhe flotës tregtare detare, por ata i kanë rikonceptuar strategjitë dhe objektivat terroriste duke parë vështirësitë që po hasin në sektorin e aviacionit"

(Boisson, 2000). Kjo mund të sjell si pasojë që organizatat terroriste të jenë duke studiuar objektiva më optimal dhe të arrirë për të goditur, pra për të sulmuar sektorin detar. Mënyrat më të mundshme të sulmeve terroriste mbi sektorin detar mund të konsiderohen rastet si p.sh: përdorimi i ngarkesës së anijes për të transportuar ilegalisht armë, drogë, terrorist apo eksploziv; përdorimi i anijes si strukturë shpërthyes; mbytja e anijeve të mëdha në kanalet ose ngushticat detare në mënyrë që të bllokohen trafikun detar; sulmi ndaj anijeve naftëmbajtëse për të shkaktuar vdekje dhe dëme financiare etj (Jones, 2006). Pavarësisht problemeve dhe kompleksitetit që paraqesin objektivat detar shumë organizata ndërkombëtare kanë shfaqur shqetësimin që industria detare është potencialisht e rrezikuar nga veprimtaritë terroriste (Giles et al, 2003).

Qeveria Amerikane ka krijuar një listë me aktet ose skenarët e mundshëm që ndoshta mund të përdoren nga terroristët duke përdorur kapacitetet operacionale ndërkombëtare të tyre për të dëmtuar industrinë detare (IMO, 2006). Lista e mësipërme përfshin përdorimin e jahteve ose mjeteve të vogla detare të mbushura me eksploziv për të goditur objektiva të ndryshëm; përdorimi i anijeve të mëdha kontejnerë ose naftëmbajtëse për të goditur anije tregtare, anije ushtarake, porte ose platformë naftë; përdorimi i anijeve komerciale si platformë për lëshimin e raketave ushtarake; përdorimi i polumbarëve për të vendosur mjete shpërthyes në porte ose anije; si dhe përdorimi i mjeteve detare pa pilot për të sulmuar objektiva. Strukturat e sigurisë në SH.B.A mendojnë që terroristët mund të kenë avantazhin në lidhje me përdorimin e ngarkesave të anijeve speciale si nafta, kimikatet e ndryshme, LNG, LPG si komponent shpërthyes për të hedhur në erë shënjestra detare (Jones, 2006).

KONKLUZIONE

Nëqoftëse do t'i referohemi analizës së mësipërme, natyrshëm lind pyetja nëse, a mund të konsiderohen të besueshme apo reale opinionet negative për Kodin ISPS mbi Sigurinë e Anijeve dhe Porteve (2002) apo për kornizën ligjore të së drejtës ndërkombëtare të detit lidhur me sigurinë detare? Duke marrë në konsideratë aktet terroriste në sektorët e industrisë së

aviacionit civil, shërbimit urban apo në sektorin e industrisë së trenave, si dhe duke marrë parasysh edhe faktin që industria detare është shënjestruar më parë nga elemente të ndryshëm terrorist apo kriminal; a mund të jemi kaq të pakujdesshëm sa të konsiderojmë industrinë detare si një sektor që nuk i kërcënohet asnjë rrezik sigurie? Po ashtu, në këtë kontekst, a mund të jenë kritikrat apo negativitetet ndaj Kodit ISPS në një mënyrë apo një tjetër të justifikuara?

Pavarësisht paralajmërimit për kërcënimet apo rreziqet që paraqet terrorizmi në det, qofte ky kërcënim real apo dhe teorikisht i konceptueshëm, tashmë ekzistojnë të dokumentuara një numër i konsiderueshëm aktiviteteve kriminale që kanë influencuar negativisht industrinë detare. Duke marrë parasysh sa më sipër, atëherë mund të themi që çdo kornize legislative me natyrë ndërkombëtare, si p.sh: Kodi ISPS, Konventa UNCLOS (1982), Konventa mbi Neutralizimin e Akteve të paligjshme Kundër Anijeve (1988) që ndihmon në minimizimin ose eliminimin total të këtyre akteve kriminale është një instrument ligjor i rëndësishëm dhe mjaft i domosdoshëm për industrinë detare dhe më gjerë. Megjithatë, duke iu referuar problematikave të caktuara ligjore dhe paqartësive juridike, normat konkrete të pasqyruara në këto instrumente ligjor duhet të amendohen e konsolidohen më tej në mënyrë që lufta kundër fenomeneve të kriminalitetit e terrorizmit detar të jetë efikase.

REFERENCAT

- *Xhelilaj, Ermal (2015). E Drejta e Detit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare Tekst (360 fq). Shtëpia Botuese Europrint, Vlore, ISBN 978-99956-95-48-4.*
- *S.M. Jones (2006). Maritime Security, Nautical Institute Publications, London, England, UK Farthing, B & Brownrigg, M. (1997). International Shipping, (3rd Edt.), Business of Shipping Series, London, Hong Kong.*
- *Boisson, F. (2000). Safety at Sea. Policies, Regulations & International Law. Bureau Veritas, Paris.*
- *Churchill, R.R. & Lowe, A.V. (1997). The Law of the Sea. Melland Schill Studies in International Law, Juris Publishing, USA, Canada.*
- *Mukherjee, P. K (2004). Maritime Legislation. World Maritime University Publications, Malmo, Sweden.*
- *O.C. Giles, N.J.J. Gaskell, C. Debatista & R.J Swatton, Chorley and Giles Shipping Law. (8th ed. London: Financial Times Pitman Publishing, 2003).*
- *Xhelilaj, E. (2008). Maritime Security. Implementation of the ISPS Code - Challenges and Limitations, World Maritime University Alumni Journal 2008, Malmo, Sweden.*
- *IMO (2001). International Maritime Organization Convention, Consolidated Edition, London, IMO Publication.*
- *IMO (2002). International Convention on Collision Regulation, London, IMO Publications.*
- *IMO (2001). International Convention on Standards of Training, Certification and Watch keeping for Seafarers, London, IMO Publication.*
- *IMO (2006). International Convention on Safety of Life at Sea, London, IMO Publications.*
- *IMO (2004). Consolidated text of the International Convention for the Safety of Life at Sea, 1974, and its Protocol of 1988: articles, annexes and certificates, IMO Publication, London, UK*
- *IMO (2000). Search and Rescue Transponder (SART), IMO Publication, London, UK United Nations (1984). Convention on the Law of the Sea. Geneva, United Nations Publications.*

SHKENCAT MJEKËSORE DHE SHËNDETËSORE

The COVID-19 Pandemic and the Level of Basic and Digital Health Literacy (eHealth) in the Adult Population - Evidence to Design Accurate, Accessible, and Practical Health Interventions

Fatjona Kamberi¹, Brunilda Subashi¹, Glodiana Sinanaj¹, Marjola Muhaj², Elida Trushaj³

¹ *Research Centre of Public Health, Faculty of Health, University of Vlore "Ismail Qemali", Vlore, Albania*

² *MSc Student, Faculty of Health, University of Vlore "Ismail Qemali", Vlore, Albania*

³ *Faculty of Health, University of Vlore "Ismail Qemali", Vlore, Albania*

Abstrakt

Kultura shëndetësore bazë përfaqëson gradën e aftësisë individuale për të gjetur, kuptuar dhe përdorur informacionin dhe shërbimet për vendime dhe veprime të lidhura me shëndetin për veten dhe të tjerët. Kultura shëndetësore digjitale përkufizohet si aftësia për të gjetur, kuptuar informacion mbi shëndetin nga burime digjitale dhe aplikimin e njohurive të fituara për të zgjidhur apo adresuar probleme shëndetësore. Kultura shëndetësore e një popullate ka efekt të konsiderueshëm në uljen e pabarazive në shëndet, ndërkohë që në situata të caktuara si në rastin e pandemisë keqinformimi mbi shëndetin mund të ketë pasojë katastrofike në shëndetin e popullatës. Boshëllëqet në përdorimin e kulturës digjitale shëndetësore sidomos në mesin e pacientëve kronik të moshuar kanë ndikime negative të konsiderueshme në shëndet. Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i nivelit të kulturës shëndetësore bazë dhe digjitale në popullatën e përgjithshme shqiptare gjatë pandemisë së COVID-19. Studimi i tipit transversal i bazuar në internet duke përdorur metodën e marrjes së mostrave zinxhir u përdor për të mbledhur të dhënat në popullatën adulte në vitin 2021. Platforma Google form u përdor për administrimin në shqip të pyetësorëve HLS-EU-Q16 (Health Literacy Survey European Questionnaire16) dhe Shkallës së Vlerësimit Digjital të Kulturës

Shëndetësore. Periudha e mbledhjes së të dhënave zgjati një muaj. Në analizën finale të studimit u përshin 255 individë të rritur mbi 18 vjeç. Moshë mesatare e pjesëmarrësve në studim ishte 29,2±SD11.03 vjeç. Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (78.4%), beqar (55.7%), të punësuar (56.9%), jetonin vetëm në shtëpinë e tyre (45.5%). 27.1% e pjesëmarrësve në studim raportuan se vuanin nga sëmundje kronike. Niveli i kulturës shëndetësore të popullatës në studim u raportua në nivel mesatar pavarësisht faktit se shumica e pjesëmarrësve ishin me arsim të lartë (85.5%). Mjaft vështirësi u raportuan në gjetjen e informacionit në lidhje me simptoma që i shqetësojnë, ku duhet të kërkojnë ndihmë nëse kanë një problem shëndetësor, dhe të kuptojnë atë që mjeku u thotë në lidhje me sëmundjen dhe gjetjen e informacionit për të menaxhuar sëmundjet e tyre kronike. Rezultatet e vlerësimit digjital të kulturës shëndetësore nga pjesëmarrësit në studim reflektoi pasiguri të lartë nga ana e tyre në lidhje me burimet informative shëndetësore që ofron Interneti, aftësinë e tyre për të gjetur në internet burime informacioni të besueshme në lidhje me shëndetin dhe në përdorimin e këtij informacioni në marrjen e vendimeve me ndikim në shëndet. Vlerësimi i nivelit të kulturës shëndetësore bazë dhe digjitale në popullatën

adulte gjatë pandemisë së COVID-19 rekomandon se është urgjente dhe imperative dizenjimi i ndërhyrjeve shëndetësore nga ana e profesionistëve të shëndetit për rritjen e nivelit të kulturës shëndetësore në përgjithësi dhe benefitet e përdorimit të eShëndetit për menaxhimin e sëmundjeve kronike. Rekomandohet gjithashtu edukimi dhe trajnimi i popullatës në lidhje me shëndetin digjital.

Fjalë-kyç: Kulturë Shëndetësore bazë dhe digjitale, COVID -19, popullatë adulte, Internet.

Abstract

Basic health literacy represents the degree of an individual's ability to find, understand, and use information and services in health-related decisions and actions for oneself and others. Digital health literacy is defined as the ability to find, understand, and apply knowledge of health information gained from digital sources to solve or address health problems. The health literacy of a population has a significant effect on reducing health inequalities, while in certain situations such as the pandemic misinformation on health can have catastrophic consequences on the health of the population. Gaps in utilizing digital health literacy especially among elderly chronic patients have significant negative impacts on health. The purpose of the study was to assess the level of basic and digital health literacy in the general Albanian population during the COVID-19 pandemic. An Internet-based transversal study using the snowballing method was used to collect data on the adult population in 2021. Google Forms was the platform used to administer the HLS-EU-Q16 (Health Literacy Survey European Questionnaire16) questionnaire and the Digital Literacy Assessment Scale in Albanian. The data collection period lasted one month. The final analysis included 255 individuals over 18 years of age. The mean age of the study participants was $29.2 \pm SD11.03$ years. The majority of participants were female (78.4%), single (55.7%), employed (56.9%), living alone in their own home (45.5%). 27.1% of study participants reported suffering from chronic diseases. Levels of health literacy in the study population resulted average despite the fact that most of the participants had higher education (85.5%). Participants reported difficulties in finding

information about symptoms that bother them, where to seek help if they have a health problem, understanding what the doctor tells them about their disease, and finding information to manage their chronic illnesses. The digital assessment of health literacy reflected high uncertainty on the part of the participants regarding the health information resources provided by the Internet, their ability to find reliable sources of information about health on the Internet, and in the use of this information in making decisions with an impact on health. The results of this assessment of the level of basic and digital health literacy in the adult population during the COVID-19 pandemic show that it is urgent and imperative to design health interventions by health professionals that increase levels of health literacy in general and the benefits of using eHealth for the management of chronic diseases. Education and training of the population regarding digital health are also recommended.

Keywords: Basic and digital health literacy, COVID -19, adult population, Internet.

Introduction

The World Health Organization (WHO) and the Centers for Disease Control and Prevention (CDC) have defined personal health literacy as the degree of an individual's ability to find, understand, and use information and services for health-related decisions and actions for themselves and others. Digital health literacy (eHealth literacy) is defined as the ability to find, understand health information from digital sources and apply the knowledge gained to solve or address health problems [1-2]. Studies have shown that the health literacy of a population has a significant effect on reducing health inequalities [3-5]. Despite this, low health literacy continues to be a common problem in the general population increasing the likelihood of chronic comorbidities and hospitalizations [6-8]. During the COVID-19 pandemic, health literacy received special attention, as misinformation or "fake" health news could have catastrophic consequences for the population's health [9-10]. For this reason, the WHO launched a special campaign to combat misinformation during the pandemic, calling it "COVID-19 infodemic" [11-12]. Dissemination of

health information not based on scientific facts adds to panic and confusion in the adult population. Taking measures to control and prevent the spread of infection such as social distancing, quarantine, total or partial closures as well as border control made digital health information the center of attention [13-14]. This also highlighted gaps in the use of digital health literacy especially among elderly chronic patients in countries with low and medium socio-economic development. Studies have shown that addressing the importance of a population's health literacy brings numerous health benefits [15]. Health literacy-based interventions are beneficial to all patients of all levels, clinicians, planners, and health system policymakers if they turn these interventions into routine care [16-17]. The integration of health literacy in the nursing curriculum especially in the adaptation of care plans to patients with low levels of health literacy affects the improvement of the quality of health care provided. Health literacy, through empowering the patient in health decision making and self-efficacy, influences the improvement of health outcomes. Different tools have been used to assess the health literacy in certain group populations or pathologies. The most used is the Health Literacy Survey European Questionnaire 47- HLS-EU-Q47. It is a European questionnaire on health literacy which consists of 47 questions [18]. This questionnaire was applied in a baseline population study conducted in Tirana which identified close statistical links between social determinants of health and health literacy [19]. Other studies conducted in our country for health literacy have focused on the population of the capital and Kosovo, while studies on digital health literacy are lacking [20-21]. Our study aimed to fill the literature gap by translating into Albanian the abbreviated, more manageable, HLS-EU-Q16 (with only 16 questions) as well as the digital tool of health literacy assessment by adding these tools to the international database of valid health literacy assessment. These tools can be adapted to different pathologies and used in clinical practice in order to increase health equity, improve the health of the population, and reduce associated health costs.

Materials and Methods

An Internet-based transversal study based on the snowballing method was used to collect the data. The purpose was to assess the level of basic and digital health literacy (eHealth) in adult population during the COVID-19 pandemic as practical evidence to design accurate, achievable, and effective health interventions in order to improve the health of population and reduce health costs.

The study population was Albanian citizens, ≥ 18 year's old, residing in Albania. Although the goal was that the target population would be the local population of the city of Vlora to give a complete overview of the health literacy of the adult population during the pandemic in the local context, due to the online nature of the study, this goal was not achieved. Data collection lasted for a period of one month during 2021. The call for participation was posted on the social networks of the working group (Facebook, Instagram, email, WhatsApp, Viber, etc) and was repeated several times. Data collection was conducted through the HLS-EU-Q16 (Health Literacy Survey European Questionnaire16) and the Digital Health Assessment Scale (eHealth Literacy Scale). These two questionnaires were transferred to Google Forms, which is accessible to everyone free of charge. To ensure consistency of the data, the questionnaires were translated and reconciled in Albanian and validated through a pilot study. The baseline health assessment questionnaire consists of 16 questions with a Linkert rating scale from 1 (very easy) to 4 (very difficult). The Digital Health Literacy Assessment Questionnaire (eHealth Literacy Scale) consists of 8 questions with 5 possible options with the obligation to select only 1 option. Participants who expressed readiness to be part of the study had the opportunity to complete the questionnaire only once.

Ethical aspects

This project is a winner funded by the research grant fund of the University of Vlore, Albania. The project has received ethical approval from the Faculty of Health. The study protocol was drafted in accordance with the ethical principles of the Helsinki Declaration on Medical Research which includes human subjects and the ethical

rules of the Checklist for Reporting Results of Internet E-Surveys (CHERRIES) [22]. All participants in the study were provided with voluntary participation, anonymity, protection of personal data in accordance with applicable law, and the opportunity to withdraw from the study at any time. Participants also had the opportunity to give informed consent through a mandatory tick box where they expressed their consent to participate in the study. If this check box was not ticked a participant could not continue completing the questionnaire.

Data analysis

Statistical analysis was conducted using the statistical software CD-C EpiInfo™ 7 software version 7.1.3.10. Descriptive statistics expressed on average, standard deviation (SD) for continuous variables, and percentages for

categorical variables were used for demographic data and study results. Cross-tabulations (MxN) and X² tests were used to test the statistical relationships between the variables. Values of $p \leq 0.05$ were considered statistically significant.

Results

Socio-demographic characteristics

The final analysis of the study included 255 individuals over 18 years of age. The mean age of the study participants was 29.2. The majority of participants were female (78.4%), with higher education (85.5%), single (55.7%), employed (56.9%), living alone in their own home (45.5%). 27.1% of study participants reported suffering from chronic diseases. The chronic disease with the highest prevalence was high blood pressure (n = 13), Table 1.

Table 1. Socio-demographic data of the study participants, n = 255

Characteristics	Frequency n	Percent %
Gender		
Male	200	78.4
Female	55	21.6
Age (years)		
Mean	29.2	
Std Dev	±11.03	
Mode	20	
Marrital status		
Married	111	43.5
Single	142	55.7
Divorced	2	0.8
Educational level		
Elementary	9	3.5
Higher school	28	11.0
University	218	85.5
Employment Status		
Employed	145	56.9
Unemployed	105	41.2
In retirement	5	2.0
Place of living		
In my house, alone	116	45.5
With my children	70	27.5
Rent	69	27.1
Presence of chronic diseases		
No	212	83.1
Yes	43	16.9
The most common chronic diseases		
High blood pressure	13	30.23
Rheumatic diseases	3	6.97
Thyroid gland disease	3	6.97

Migraine	4	9.31
Chronic gastrointestinal diseases (gastritis, ulcers)	5	11.26
Kidney disease	3	6.97
Multiscleorsis	3	6.97
Talasemi major	3	6.97
Ovarian cysts	4	9.31
Diabetes	2	4.65
TOTAL	255	100

Results of the HLS-EU-Q16 questionnaire (Health Literacy Survey European Questionnaire16)

Table 2 shows the results of the 16 questions of the Health Literacy Survey European Questionnaire16. From this table, it is notable that, as per the first 8 questions, most participants reported that they had very easy access to health information. Despite this, a considerable percentage of participants selected the equivalent of

“quite difficult” in response to all the questions. No statistically significant associations were identified between health literacy (first 8 questions) and gender, $p \geq 0.05$. Statistical correlations were identified between Question 1, Question 9, $p = 0.004$; Question 10, $p = 0.0005$ and educational level.

Table 2. Health Literacy Survey European Questionnaire16

HLS-EU-Q16 questions	Very easy n (%)	Quite easy n(%)	Quite difficult n (%)	Very difficult n (%)
1. How easy or difficult would you say it is to find information about the symptoms of the diseases that bother you?	106(41,6)	48(18,8)	87(34,1)	14(5,5)
2. How easy or difficult would it be to find out where you can get help from health professionals when you are sick?	106(40,8)	64(25,1)	74(29,0)	13(5,1)
3. How easy or difficult would you say it is to understand what your doctor is telling you?	103(40,4)	36(14,1)	107(42,0)	9(3,5)
4. How easy or difficult would you say it is to understand your doctor or pharmacist's instructions on how to take a prescription medicine?	79(31,0)	20(7,8)	146(57,3)	10(3,9)
5. How easy or difficult would you say it is to judge when you should get a second opinion from another doctor?	96(37,6)	86(33,7)	60(23,5)	13(5,1)
6. How easy or difficult would you say it is to use the information (Instructions: treatment, treatment options) given to you by your doctor to make decisions to treat your illness?	85(33,3)	46(18,0)	116(45,5)	8(3,1)
7. How easy or difficult you would say it is to follow the instructions of your doctor or pharmacist?	95(37,3)	24(9,4)	130(51,0)	6(2,4)
8. How easy or difficult would it be to find information on how to manage problems such as stress or depression?	77(30,2)	93(36,5)	65(25,5)	20(7,8)
9. How easy or difficult would you say it is to understand the health risks of behaviors such as smoking, lack of exercise, excessive alcohol consumption?	76(29,8)	49(19,2)	117(45,9)	13(5,1)
10. How easy or difficult would you say it is to understand why it is necessary to do preventive medical examinations? (Instructions: mammography, diabetes test, blood pressure control)	85(33,3)	42(16,5)	122(47,8)	6(2,4)

11. How easy or difficult would you say it is to judge whether information on health risks (e.g. poor diet, lack of physical and mental exercise, obesity, smoking, environmental pollution, etc.) as presented in the media is credible? (Instructions: TV, internet or other media)	100(39,2)	51(20,0)	83(32,5)	21(8,2)
12. How easy or difficult would it be to decide how you can protect yourself from a disease based on media information?	78(30,6)	93(36,5)	58(22,7)	26(10,2)
13. How easy or difficult would you say it is to find activities that are good for your mood? (Instructions: exercise, walking, going out with friends, etc.)	98(38,4)	43(16,9)	104(40,8)	10(3,9)
